

SAKRAMENTET E KISHËS KATOLIKE

Vazhdojmë rrugëtimin tonë të Sakramenteve të Kishës Katolike, duke u futur dalëngadalë në grupin e fundit të Sakramenteve të Kishës Katolike. Këto 7 shenja të shenjta që Nëna Kishë na dhuron i kemi ndarë në tre grupe të mëdha, pak a shumë (edhe pse këto gjëra nuk mund të priten me thikë) mbi bazën e "rolit" që ata kanë në jetën e krishterë të njeriut: Sakramentet e Hyrjes në jetën e krishterë (Pagëzimi, Krezmimi, Kungimi), Sakramentet e shërimit (Rrëfimi dhe Vajimi) dhe Sakramentet në shërbim të bashkësisë e të misionit (Martesa dhe Urdhri i shenjtë). Pra, ne do të futemi në grupin e Sakramenteve në shërbim të bashkësisës e të misionit, konkretisht do të flasim për Sakramentin e Martesës, që disa e njohin ndryshe me emrin Kurora, ose Martesa në Kishë.

BURIMET ZYRTARE

Përpara se të zhytemi në botën e mrekullueshme të këtij Sakramenti (dhe sa shumë gjëra ka për të thënë në lidhje me të!) ja vlen të përmendim, si gjithmonë, burimet zyrtare nga të cilat zakonisht i marr këto informacione që janë websiti zyrtar i Kishës Katolike vatican.va, websiti i etërve domenikanë Amici Domenicani, me përgjigje të teologut Atë Angelo Bellon dhe websiti i priftit italian Don Leonardo Maria Pompei: In Voluntate Dei.

SAKRAMENTI I MARTESËS

Fillojmë një Sakrament tjetër shumë të rëndësishëm dhe të bukur, që futet në Sakramentet në shërbim të bashkësisë e të misionit sikurse thamë, që është Sakramenti i Martesës. Më pëlqen të nis me një koinçidencë ose siç më pëlqen mua t'i quaj, Zotinçidencë (një lojë fjalësh banale), që po nis të shkruaj mbi këtë Sakrament pikërisht më 23 janar të vitit 2022, që është dita në të cilën Kisha kujton Martesën e Jozefit e të Marisë, që janë dy të martuarit më të shënjtë në të gjithë historinë e njerëzimit, janë modeli i çdo të martuari, të krishterë së pari, por edhe në përgjithësi pasi martesa e tyre ishte aq perfekte në dashuri dhe në virtyte, sa çdo njeri i çdo feje, krahine dhe ideje do të donte të mësonte nga ata e të imitonte këtë lloj martese.

Tani, është shumë bukur të mendojmë e të meditojmë mbi Sakramentin e Martesës, sidomos mbi Martesën e Jozefit e të Marisë, që ka qenë një martesë e vërtetë, 100 %, edhe pse mund të duket në pamje të parë që s'ka qenë e tillë, që ka qenë pak e çuditshme, sigurisht jashtë normave të martesave të zakonshme.

Shumica prej nesh, sidomos më përpara kur televizioni italian shikohej më shumë në Shqipëri, mund të ketë dëgjuar për familjen e Mullirit të Bardhë (Mulino Bianco). Jo se dua t'i bëj publicitet, se s'kam asnjë lloj interesi, por në italisht përdoret edhe si shprehje e përgjithshme, për të treguar familjen ideale, siç ishte pak a shumë ajo që na



tregonte publiciteti i Mullirit të Bardhë, ku nëna, babai e fëmijët (mundësisht të gjithë të bukur, të palestruar, të veshur mirë e të rregulluar që në pikë të mëngjesit, gjë që për një njeri normal, një tokësor çfarëdo, nuk ndodh kurrë, përkundrazi) viheshin të gjithë së bashku rrëth tavolinës së kuzhinës duke ngrënë mëngjes, duke ndihmuar njëri tjetrin, gruaja e burri shikonin njëri tjetrin me ato sytë tipike të adoleshentëve të porsadashuruar (të padurueshëm meqë ra fjala) dhe biri e bija i dëgjonin prindërit, sillnin gjërat në tavolinë, puthnin nënë e babë e gjëra të tilla (kur ndodhin këto gjëra në të vërtetë?!). Pra, krejt përralla, do të kemi menduar ne. Pse?

Sepse në fakt, shumica prej nesh, kur mendon për martesën, dhe si pasojë për familjen, por le të ndalemi tek hapi i parë që është ai i martesës, ka këtë martesë në mendje!



Mos u trembni! Është një foto e bërë gjatë një dasme para viteve '90 në Shqipëri, ku siç e dimë ekzistonte dhe ndoshta në disa vende akoma ekziston, kjo traditë që nusja, përpara se të dilte nga shtëpia e familjes së saj të origjinës, pra përpara se të linte nënën, babanë, gjyshin, nusen e dajës, kushërirën e djalit të xhaxhait etj etj (se nuk e di sa mijëra vetë jetonin përpara së bashku në një shtëpi), duhej të qante tek dilte nga dera e shtëpisë, deri në momentin që futej në makinë, ku kishte ardhur dhëndrri për ta marrë. Po jo të qarë e gjë, po me zë të lartë! E mbaj mend kur janë martuar disa të afërm të mi, se si kanë qarë me zë të lartë, dukej sikur ishe në një funeral, më shumë se sa në një martesë! Dhe gjëja më e fortë ishte kjo qarje, në shumicën e kohës, ishte krejt e shtirur se kishte ca vajza që mezi prisnin që të linin shtëpinë e tyre!!!

Nejse, tani përveç faktit që doja të rikujtoja pak për qejf këtë zakon kaq të çuditshëm të martesave në Shqipëri, më pëlqeu dhe e mora këtë foto edhe sepse është diçka shumë domethënëse, duke qenë se kjo nuse po qan prej zakonit (ose prej emocionit) por në fakt simbolizon në një farë mënyre martesën e parë me sytë njerëzore: fatkeqësisht, martesë për shumë njerëz, e sidomos për gratë por nuk po përjashtoj as meshkujt, shikohet si diçka negative,

si diçka për t'i qëndruar larg, si diçka që ta mërziq aq shumë sa me taman jo rrallëherë gratë mund ta gjejnë veten në vend të kësaj nuseje që qan, por jo për shtirje apo për emocion siç ishte zakoni, por me të vërtetë, nga zemra, nga thellësia e zemrës. Përbiles, bashkëshorti ose bashkëshortja mund të bëhen aq të padurueshëm, sa i shtyn njerëzit e zakonshëm, por edhe komedianët, aktorët etj të bëjnë batuta, komedi e filma të ndryshëm mbi këtë lloj marrëdhënieje, që është një ndër më të rëndësishmet dhe më intimitet e jetës së dy njerëzve. Jo më larg se dje, kur ishim duke vizituar një pacient, doktori ju drejtua një burri rreth të 60ve, nga Kalabria, ndërkohë që e mjekonte dhe pasi ai i tha që ishte i martuar prej 40 vitesh: Po më fal a e ke shtëpinë në fshat, a ke një copë kopsht a diçka të tillë, jashtë, për qejf? - Dhe pacienti ju përgjigj: Po doktor, e kam.- Ok, mund të bësh ndonjë gropë e ta fusësh, ashtu fshehurazi... (e kishte fjalën për gruan normalisht!) - Dhe pacienti ju përgjigj, duke i bërë të gjithë repartin që të qeshë: - Po, doktor, por nuk vdes! Nuk vdes, është e kotë, është e pavdekshme!

Pra, ishte një episod (ndoshta i një shakaje pak si të rëndë, shaka doktorash) për të treguar se si me të vërtetë bashkëjetesa midis dy njerëzve mund të mos jetë e lehtë, përkundrazi, mund të bëhet aq e vështirë, me aq shumë pengesa, vuajtje, peripeci sa t'i bëjë njerëzit që të bëjnë-minimumi- shaka të tilla, por fatkeqësisht disa kalojnë edhe në fakte. Atëhere pyetja është, për t'ju rikthyer temës sonë të Sakramenteve: Nga se lind ky Sakrament i Martesës? Ku i ka rrënjët? Për çfarë shërben në të vërtetë dhe cilat janë efektet e tij në jetën e njerëzve që e marrin? Dhe mbi të gjitha, cilat janë karakteristikat e tij, që e dallojnë nga martesat e tjera, psh martesat në komunë apo martesat në objektet e tjera të kulteve të feve të ndryshme? Të gjitha këtyre pyetjeve, një nga një, do të mundohemi t'u japim përgjigje.

1. ÇFARË ËSHTË MARTESA?

Pakti martesor, me anë të të cilit burri e gruaja vendosin midis tyre bashkëndarjen e jetës së tyre, për natyrën e vet e drejtuar tek e mira e bashkëshortëve dhe tek riprodhimi dhe edukimi i fëmijëve, ndër të pagëzuarit është ngritur nga vetë Krishti Zot në dinjitetin e sakramentit. (KKK 1601)

Çfarë do të thotë kjo? Që së pari duhet të dallojmë midis martesës "natyrore", pra që martesës në vetvete, siç e ka menduar Hyji që në fillimet e krijimit, kur ka krijuar botën dhe sidomos burrin e gruan, dhe martesës "sakramentale", pra martesës në kishë. Sepse ka pikë të përbashkëta, përbiles kjo e fundit mbështetet tek e para, por nuk është krejt njësoj si e para, përkundrazi ka diçka më shumë, sepse siç e lexuam fjalia na thotë: është ngritur në dinjitetin e një Sakramenti, pra sigurisht nuk është sikur e parë, edhe pse i ka bazat dhe rrënjët në të, por është shumë më lart se e para. Për të kuptuar martesën sakramentale, le të fillojmë nga origjina: nga martesat "natyrore".

A. MARTESA "NATYRORE"

Martesa midis burrit dhe gruas ka qenë në planet e Zotit që në fillimet e krijimit, siç do të shikojmë pak më poshtë, dhe përbiles është kaq "i fiksuar" Zoti me këtë fjalë, sa Shkrimi i Shenjtë përmbillet po me këtë fjalë, më konkretisht me "dasmën e Qengjit":

Atëherë më tha: Shkruaj! Të lumët ata që janë të thirrur në gostinë e dasmës së Qengjit.
(Zbulesa 19, 9).

Normalisht, kjo e fundit nuk është një martesë midis një burri e një gruaje në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, por martesës mbi njeriut dhe Qengjit (pra që shëmbellen Jezu Krishtin, Qengji i Hyjit), por dua të them që me të vërtetë Zoti fjalën "martesë", fenomenin "martesë" e ka shumë përzemër, aq sa të fillojë e mbarojë Shkrimin e Shenjtë, pra që është Fjala e Tij, e vetë Zotit, me martesën. Atëhere lind nevoja për të kuptuar akoma edhe më shumë kuptimin e martesës dhe mbi të gjitha se si e ka menduar Zoti martesën, pse e ka krijuar.


Pra, nga se po themi deri tani, e kuptuam që **vetë Zoti, Krijuesi i tokës dhe i qiellit, e ka themeluar martesën** (deri tani po flasim për martesën siç e quajtmë "natyrore", jo sakramentale). Vetë Zoti është autori i martesës! Është ai që e ka "krijuar", "shpikur", themeluar martesën. Pra, thirrja për t'u martuar është e shkruar në natyrën e vetë njeriut, e çdo burri dhe çdo gruaje, që kanë dalë nga duart e Zotit Krijuesit tonë. Pra, Zoti na ka krijuar të gjithëve të tillë, për martesën, në fillim. E përsërisim që **martesa nuk është një institucion njerëzor, por hyjnor, sepse autori e saj është Hyji, vetë Zoti**. Edhe pse tashmë ka kaluar shumë kohë nga themelimi i saj (pra nga krijimi i botës e kemi fjalën) e deri në ditët tona dhe kështu që martesa natyrore ndër shekuj e ndër vite ka pësuar shumë ndryshime njerëzore dhe në disa vende, fe e kultura të ndryshme është edhe "shpërfytyruar", duke e humbur pothuaj kuptimin e saj fillestar siç e kishte menduar Zoti dhe duke e humbur sakralitetin e saj, kjo nuk do të thotë që këto gjëra nuk janë akoma të vërteta për njeriun, që do apo s'do ta besojë, është krijuar nga Zoti i tillë, dhe kjo vlen jo vetëm për Adamin dhe Evën dhe fëmijët e tyre, por për secilin prej nesh.

Hyji është dashuri, na thotë Gjoni në letrën e tij të parë (Letra e parë e Gjonit 4, 8) dhe duke qenë se e ka krijuar njeriun sipas imazhit dhe përngjashmërisë së tij dhe duke qenë se i ka krijuar mashkull e femër, i ka krijuar në mënyrë të tillë që dashuria e tyre reciproke të bëhet një imazh i vërtetë i dashurisë absolute dhe perfekte që Zoti ka për njeriun, për çdo njeri. Pra, siç e shikojmë, edhe vetë martesa natyrore, që është gjithësesi e themeluar nga Zoti dhe nuk ka akoma dinjitetin tejet të lartë të martesës sakramentale, por prapë se prapë ka një dinjitet të madh dhe të pacënueshëm në vetvete, që shkon përtej asaj çka thuhet për martesën "s'kam nevojë për një copë letër unë, apo për një kontratë, për të konfirmuar dashurinë që ndjej për bashkëshortin/en time" ose "martesa veç prish punë, ç'a po i duhet njeriut që të martohet e të ngatërrojë punë vetes duke u lidhur me një njeri gjithë jetën, pastaj ja shikon sherrin asaj/atij me gjithë familje" ose "ç'a po të duhet me u martu, lidhu, ndaju, bashkëjeto, jemi në një shoqëri të lirë tani dhe mund të bëjmë secili çfarë të dojë, çfarë të ndjejë se është gjëja më e drejtë dhe më e duhur" e fraza e mendime

të tilla për martesën. Pra, në mendjen e Zotit, dhe duhet të kemi parasysh që kur diçka është në mendjen e Zotit, automatikisht do të thotë që kjo gjë është e vërteta absolute dhe nuk ka një të vërtetë tjetër që ta kundërshtojë këtë: pra ajo çka është në mendjen e Zotit, në planet e tij, është realiteti, gjithçka çfarë ne mendojmë apo si i shikojmë gjërat janë mendimet tona, që edhe pse mund të duken të drejta ose "realiste", nuk janë aspak realiteti. Atëhere martesë është shumë më shumë se ato që thamë më sipër, që sigurisht duhet t'i kemi dëgjuar të gjithë, është një thirrje e veçantë për çdo njeri të krijuar nga Hyji, që të dojë bashkëshortin/en e tij, fatin e tij pra, në mënyrë të ngjashme, sikur Hyji e do atë. Është një thirrje e lartë, është diçka serioze, nuk është një shaka, as diçka romantike e tipit "puçi puçi"! Ja të lexojmë së bashku zanafillën tonë, të qenies njerëzore, të llojit njerëzor, në burrin e parë (Adami) dhe në gruan e parë (Eva), pra çastin kur u krijua njeriu nga Zoti:

“Hyji tha: “Le ta bëjmë njeriun në shëmbëlltyrën e në përngjasimin tonë që të jetë zotërues i peshqve të detit, i shpendëve të qiellit, i kafshëve, i mbarë tokës, dhe i çdo zvarraniku që zvarritet mbi tokë”! Hyji krijoi njeriun në përngjasimin e vet, e krijoi në përngjasimin e Hyjit; i krijoi mashkull e femër. Hyji i bekoj dhe u tha: “Shtohuni e shumohuni e mbusheni tokën dhe sundojeni atë! Bëhuni zotëruesit e peshqve të detit, të shpendëve të qiellit dhe të çdo gjallesë që lëviz përmbi tokë” (Zanafilla 1,26-28).


Por nuk mjafton më kaq. Zoti i krijoi mashkull e femër jo vetëm që nëpërmjet dashurisë që i japin njëri tjetrit të shëmbëlajnë dashurinë që Zoti ka për krijesat e tij, "martesën" mistike që Zoti Krijuesi ynë dëshiron thellësisht të bëjë me çdo shpirt njeriu, sepse çdo shpirt njeriu ka dalë nga Gjiri i Hyjit dhe është krijuar për të jetuar i bashkuar plotësisht me Hyjin, por edhe që ta ndihmojnë njëri tjetrin. Do ta lexojmë pas pak, gjithnjë nga libri i Zanafillës së Dhjatës së Vjetër, që Adami ishte i mërztur, se ok ishte zotëruesi i të gjithë kafashëve, zvarranikëve, shpendëve, zhapikëve, po me gjithë respektin për zhapikët e për bretkosat, por çka po i duheshin? Mërzitej gjithë ditën me to, sepse nuk mund të fliste me to, nuk mund të ndante mendimet e tij me to. E vinte re se kishte një ndryshim midis tij dhe atyre, sepse për sa të bukura mund të ishin, prapë se prapë nuk ishin si ai, nuk mendonin, nuk llogjikonin, nuk kishin pra të njëjtin shpirt. (Kjo pjesë nuk është taman kështu në Bibël, por le të themi se po imagjinoj pak "prapaskenat"



biblike). Atëhere, Zoti i thotë "Nuk është mirë që mashkulli të rrijë vetëm" dhe i krijon femrën "mish i mishit të tij", krejt e ngjashme me të, krejt e afërt me të, si një ndihmë e vërtetë.

Zoti Hyj tha edhe: "Nuk është mirë që njeriu të jetë vetëm: do t'ia bëj një ndihmë që t'i përngajë". Pasi Zoti Hyj i kishte formuar prej dheut të gjitha kafshët e gjalla të fushës dhe të gjithë shpendët e qiellit, i solli te njeriu, për të parë, se si do t'i quajë, sepse secila kafshë e gjallë do të mbante atë emër, me të cilin do ta quante njeriu. Njeriu ia ngjiti emrin përkatës secilës bagëti, secilit shpend të qiellit dhe secilës egërsirë të fushës; por për njeriun nuk gjendej një ndihmës që t'i përngjante atij. Prandaj, Zoti Hyj i lëshoi njeriut një gjumë të rëndë. Pasi e zuri gjumi, ia nxori një brinjë dhe vendin e saj e mbushi me mish. Zoti Hyj e përftoi gruan prej brinjës që ia kishte nxjerrë njeriut dhe e solli te njeriu. Atëherë njeriu klithi: "Kjo tani është ashti i eshtrave të mi dhe mishi i mishit tim! Le të quhet Grua, sepse kjo u mor nga njeriu". Për këtë arsye njeriu do ta lërë të atin dhe t'ëmën e vet dhe do të jetojë bashkë me gruan e vet e do të bëhen një trup i vetëm. (Zanafilla 2, 18-24)

Por prit se nuk ka mbaruar këtu! Sikur të mos mjaftonin këto më sipër, dhe besoj se janë mjaftueshëm deri tani, ka një fjali në veçanti që godet, që është " për këtë arsye njeriu do ta lërë të atin dhe t'ëmën e vet dhe do të jetojë bashkë me gruan e vet e do të bëhen një trup i vetëm". Sa bukur! Këto fjale, që nuk janë fjale romantike të thëna banalisht, sepse Zoti kur flet, flet seriozisht, dhe çdo fjale e nxjerrë nga goja e Zotit dhe e shkruar në faqet e arta të Shkrimit të Shenjtë ka një rëndësi dhe peshë të jashtëzakonshme, të cilën nuk duhet t'i nënvlerësojmë. **Realiteti që ndodh në martesën, realitet që siç do të shikojmë spikat akoma më shumë në martesën sakramentale, por siç e po shohim tani vlen edhe për martesën "natyrore", është që gruaja e burri që martohen bëhen një mish i vetëm, një trup i vetëm.** Përbiles Jezusi vetë e përsërit këtë gjë, dhe e gjejmë në ungjillin e Mateut:



Jezusi iu përgjigj: "A nuk keni lexuar: Krijuesi, kur i krijoi në fillim i krijoi mashkull e femër e tha: 'Për këtë arsye njeriu do ta lërë babain e nënën e vet e do të jetojë me gruan e vet e të dy do të jenë një trup i vetëm?' (Mateu 19, 4-5)

Pasoja e këtij realiteti, pra që nëpërmjet martesës burri e gruaja "bëhen një trup i vetëm" janë të mëdha dhe do t'i shikojmë me vëmendje kur të flasim për martesën sakramentale.

Martesa "natyrore", ashtu siç është menduar nga Hyji që nga fillimet e njerëzimit, është diçka e jashtëzakonshme, por ajo fotoja për të cilën folëm në fillim, e gruas që qan si e dëshpëruar, neve nuk na hiqet nga mendja lehtësisht dhe na bën të mendojmë mbi sakralitetin dhe madhësinë e kësaj "shpikjeje" të Zotit: ku është e gjithë kjo bukuri, ky është e gjithë kjo mrekulli e martesës, unë s'po e shoh kund: unë shoh më shumë mërziqe, ngatërresa, xhelozë, zënka, shamata, keqkuptime, mosmarrëveshje, indiferenca, ndarje, divorce etj etj. Po është e vërtetë, bukuria e realitete në projektet e Zotit nuk duhet të bëjë që të harrojmë realitetin në tërësinë e tij: realitetin e njerëzimit të goditur nga mëkati, nga mëkati origjinal së pari, por edhe mëkatet personale. Pasojat e mëkatit janë të tmerrshme (Shiko: Mëkati i rëndë) dhe këto pasoja i shikojmë edhe tek martesja, që tashmë është shpërftyruar aq shumë, sa duket sikur nuk është më sikur ajo që Zoti e ka menduar për ne, këto që po themi duken gati gati si përralla.

Ky unitet i thellë i bashkëshortëve ashtu siç e ka menduar Zoti dhe po ashtu pazgjidhshmëria dhe besnikëria e martesës (për të cilat do të flasim më tej) e kanë humbur vlerën dhe kuptimin e tyre ndër vite dhe sidomos në disa kultura e vende që janë influencuar nga elemente të tjera si psh divorci, poligamia, por duhet të kemi parasysh që edhe në Dhjatën e Vjetër, pra në ngjarjet para lindjes së Jezu Krishtit, profetët kanë folur për martesën me këto karakteristika dhe vlera si besnikëria, monogamia, pazgjidhshmëria, sidomos mund t'i gjejmë në disa libra të Besëlidhjes së Vjetër që janë libri i Rutit, libri i Tobisë dhe mbi të gjitha Kantiku i Kantikëve.

M'vendos si vulë mbi zemrën tënde, porsì vulë mbi dorën tënde se dashuria është e fortë si vdekja, i pashmangshëm është si dheu i zi lakmimi; vapa e saj si vapa e zjarrit, flakë hyjnore! Ujërat e mëdha dashurinë nuk mund ta ndalin, nuk e fikin as lumenjtë! Kush do të jepte gjithçka ka në shtëpinë e vet me qëllim të blejë dashurinë, do të përbufej prej gjithkujt. (Kantiku i Kantikëve 8, 6-7)

B. MARTESA SAKRAMENTALE

Thamë shumë gjëra të bukura e të rëndësishme për martesën "natyrore", martesën midis një gruaje dhe burri të rruzullit tokësor ashtu sikur e ka menduar Zoti që në fillimet e krijimit. Dikush mund të mendojë: po i the të gjitha kur fole për martesën natyrore, çfarë do të thuash tani për martesën sakramentale, ose më mirë, pse ishte e nevojshme që të "shpikjej" kjo gjë e re, një sakrament i ri i martesës? Kjo është pyetje themelore, sepse nqs e kuptojmë rrënjësisht bukurinë e sakramentit të martesës dhe rëndësinë e tij, pastaj të gjitha gjërat e tjera do vijnë më spontanisht dhe do të dimë t'i përgjigjemi sinqerisht e thellësisht pyetjes "Po pse të



martohem në kishë, ne e duam njëri tjetrin nuk ja ndjejmë nevojën të shtojmë asgjë më tepër". Jo më larg se para pak javësh, duke folur me një vajzë, e pagëzuar ortodokse por jo praktikante në fenë e saj, më përsëriti pikërisht këto fjalë, duke folur në lidhje me bashkëjetesën me të fejuarin e saj. Dhe është krejt normale, sepse përgjigja qëndron pikërisht tek pjesa e dytë e asaj fraze "Nuk ja ndjejmë nevojën". Kur nuk i ndihet nevoja diçkaje? Ose kur nuk ka fare rëndësi (dhe nuk është ky rasti i Sakramenteve sepse përndryshe nuk do të isha këtu duke humbur "frymë" kot) ose kur nuk i dihet rëndësia (dhe është ky rasti i këtij Sakramenti). Por të shkojmë pak më thellë tani, që ta kuptojmë mirë rrënjën e kësaj pyetjeje thelbësore: Kur nuk i dihet rëndësia sakramentit të Martesës?

Përgjigja është: kur nuk i dihet rëndësia sakramentit të Pagëzimit. Ou?! Po çka lidhje ka Pagëzimi, e kam bërë kur kam qenë 6 muajsh, as nuk e mbaj mend, çka lidhje ka me martesën në kishë që po e kam bërë pas 30 vitesh? Ka lidhje, sepse jo më kot i kemi ndarë sakramentet e Kishës Katolike në tre kategori, dhe pika e parë e kategorisë së parë ishte Pagëzimi, që është Sakramenti i parë i hyrjes në jetën e krishterë. Pagëzimi na fut në jetën e krishterë, në jetën e hirit, në jetën e Jezu Krishtit. Është një farë e vockël fare, e cila duhet të ujitet e të kujdesemi për të me shumë përkujdes e dashuri që të rritet e të përforcohet. Por problemi është pikërisht ky: nuk mund t'ja kuptojmë rëndësinë sakramentit të Martesës dhe pra si pasojë të vendosim të martohemi në kishë, nqs nuk jemi futur në jetën e krishterë, që është jeta që i jep jetë dhe ushqim këtij sakramenti. Po më fal, unë jam pagëzuar, si nuk qenkam futur, a the vetë se ato që pagëzohen futen në jetën e krishterë, çka po thua tani? Po, jemi futur me të vërtetë, por nuk jemi të vetëdijshëm që jemi futur sepse asnjë njeri nuk na ka folur kurrë më për jetën e krishterë (siç kishte ndodhur psh. me këtë vajzën ortodokse) ose na kanë folur dhe për një farë kohe ndoshta jemi edhe interesuar dhe mund edhe ta kemi jetuar këtë jetë, por pastaj për motive të ndryshme, i pari dhe kryesori ndër të cilët është mëkati, kemi dalë nga kjo jetë dhe bëjmë një jetë praktikisht sikur të mos ishim të pagëzuar. Atëhere, është normale që shumë të rinj (dhe më pak të rinj) që janë të pagëzuar, sot nuk e ndjejnë nevojën për t'u martuar në kishë: ka përfunduar ajo kohë që bëheshin gjërat për hatër të mamit, të gjyshes apo të tezes, ka përfunduar ajo kohë ku "po nuk ishe i martuar në kishë shikoheshe keq nga shoqëria (edhe pse kjo ndoshta nuk vlen shumë për shoqërinë shqiptare që nuk është një shoqëri me magjorancë të krishterë)" dhe tani liria e plotë që gëzojmë na lejon që t'i themi lirisht "jo" martesës në kishë, sepse s'më intereson, sepse "nuk besoj në të", sepse "s'dua të humbas kohë me të" etj. Atëhere, pika nga e cila duhet të fillojmë, nqs jemi sado pak të interesuar për të ditur për martesën sakramentale, nuk është martesë në kishë në vetvete, por është jeta jonë e krishterë: në çfarë pike është jeta ime e krishterë? A besoj në Zot, së pari? A besoj në Jezu Krishtin dhe në Kishën e tij? A besoj në Sakramentet e Kishës Katolike, që ato janë themeluar nga vetë Jezu Krishti për të mirën time, për ecjen time, për jetën time? Pastaj, a besoj tek martesë sakramentale?

Ok, pasi i dhamë përgjigje të gjitha këtyre pyetjeve, e mund të na duhen edhe vite për t'u dhënë përgjigje seriozisht, i bëjmë një pyetje vetes: Cili është objektivi i jetës sime, pra pse jam në këtë jetë? Ah, pyetje e bukur kjo! Hajde, ulu, merr e ha ndonjë kikirik, pi pak raki (preferoj coca

colën, edhe pse e di se nuk është shumë e shëndetshme) dhe të flasim, të filozofojmë për orë të tëra: se kjo është ajo që mendojmë, se kushedi se çka duhet të mendojmë tani, çka duhet të nxjerrim nga thesi. Jo, nuk është ashtu! Nuk keni nevojë ta lodhim trurin fare, përgjigjen na e jep vetë Fjala e Zotit, në librin e Levitikut:

Jini të shenjtë, sepse unë jam i shenjtë, Zoti, Hyji juaj (Levitiku 19, 2).

Ky pra është objektivi real i jetës sonë, i jetës së secilës qenie njerëzore, pra edhe imi e yti. Por siç thamë për martesën "natyrore" që një gjë është ajo që mendon Zoti për ne, që është e vërteta dhe realiteti, por një gjë tjetër që është ajo që mendojmë ne për veten tonë. Kështu që objektivi i jetës sonë, sipas Zotit, është që të bëhemi të shenjtë, po për ne, po për ty, cili është objektivi i jetës tënde (e kam fjalën për objektivin themelor, atë mbi të cilin pastaj bazohen të gjitha objektivet e vogla e të mëdha që mund të kemi në jetë)? Siç e shikojmë e siç do ta shikojmë disa herë gjatë këtij rrugëtimi, është e kotë të vazhdojmë të flasim më tej, nqs nuk kemi përcaktuar akoma objektivin e jetës sonë.

Ok, pasi ta kemi përcaktuar, dhe të shpresojmë që të jetë ai i shenjtërimin tonë, pra që të përputhet me objektivin që ka Zoti për ne, atëhere mund të marrim frymë lirisht e mund të vazhdojmë të flasim për martesën sakramentale, se tani po që ka kuptim. **Pra, objektivi themelor i martesës sakramentale, i faktit që martesë natyrore është ngritur nga Krishti në dinjitetin e një sakramenti, është bërë sakrament, është shenjtërimi i secilit prej nesh, sepse Zoti nëpërmjet martesës sakramentale, do të na bëjë shenjt.** Po dikush mund të thotë: po unë s'dua të bëhem shenjt, kush e tha që ky është objektivi themelor? S'dua të bëhem si Nënë Tereza aty, si murgeshë që lutet 20 orë në ditë apo si ato që merren vetëm me të varfrit; as dua të jem si Padre Pio që kalonte jetën e vet në rrëfyesor! Po kush e tha që duhet të bëhemi si ato? Thamë që të bëhemi shenjt, jo të bëhemi modeomos prift, murgeshë, apo si Nënë Tereza e Padre Pio. Mund dhe duhet të bëhemi shën "vetvetja", pra Shenjtja Marilda, Shën Sabina, Shën Flora e kështu me radhë mund të vendosim secilin emrin tonë, veten tonë. Gjithashtu të bëhemi shenjt nuk është diçka e mërziqshme apo e bezdisshme, shenjt do të thotë i lumë (është e njëjta gjë), i lumë do të thotë i lumtur. **Pra, Zoti na do të lumtur.**

Ky është objektivi kryesor i Martesës Sakramentale: t'i bëjë bashkëshortin e bashkëshorten shenjt nëpërmjet këtij "mjeti specifik të hirit" që është sakramenti i Martesës, dmth t'i bëjë të lumtur, dhe po ashtu duke qenë "sakrament" i vërtetë, efikas, është sikur sakramentet e tjera një "shenjë e shenjtë", pra një shenjë efikase e një realiteti më të thellë e më të fshehur që është Aleanca ("Martesa") e Jezu Krishtit me Kishën, dmth me secilin prej nesh.

Tani që u futëm në botën e martesës sakramentale, duke qenë ky objektivi i këtyre faqeve katekizmi, atëhere pyetjet që do të bëjmë tani e tutje do të jenë të gjitha në lidhje me Martesën Sakramentale (Sakramentin e Martesës).

2. KUR U THEMELUA SAKRAMENTI I MARTESËS?

Kemi disa pjesë biblike, specifiku të Besëlidhjes së Re, në të cilën Jezusi flet për martesën. Së pari, Jezusi flet për martesën "natyrore" kur, i pyetur nga farizenjtë se a lejohet divorci, pra që të ndahen burri dhe gruaja të bashkuar në një martesë (bëhej fjalë për martesë sikur e quajtmë "natyrore" sepse akoma nuk njihet Martesa në Kishë, aq më tepër që akoma nuk kishte as objekte kulturi të krishterë). Ata ja bëjnë këtë pyetje Jezusit sepse Moisiu (kemi thënë disa herë që hebrenjtë ishin "të fiksuar" pas Moisiut dhe Ligjit të tij) ja kishte lejuar divorcin, pra ata mund të divorcoheshin. Atëherë Jezusi, pa lënë vend për keqkuptime, u përgjigjet që në fakt ky nuk është vullneti i Hyjit, por i njerëzve, dhe Moisiu, edhe pse profet i mirë i Zotit, ja ka lejuar (pra lejuar, jo dashur drejtpërdrejtë) divorcin për shkak të ngurtësisë së zemrës së tyre: pra shkurt, ta përkthejmë pak me fjalët tona, s'kishte nga të shkonte se ato donin të divorcoheshin e o bëje, o s'ka. Tani, Jezusi u konfirmon që divorci nuk është vullneti i Hyjit, por i njerëzve. Kështu, duke ju kujtuar e përmendur vargjet biblike që i kemi shkruar më sipër të Zanafillës, **ai e rikthen martesën në origjinën e vet, ashtu sikurse Hyji e kishte menduar në fillim të Krijimit të botës e të njeriut. Këtë e gjejmë në ungjillin sipas Mateut:**

Atëherë iu paraqitën disa farisenj dhe, me qëllim që ta sprovonin, e pyetën: "A është e lejueshme ta lëshojë burri gruan për ndonjë arsye." Jezusi iu përgjigj: "A nuk keni lexuar: Krijuesi, kur i krijoi në fillim i krijoi mashkull e femër e tha: 'Për këtë arsye njeriu do ta lërë babain e nënën e vet e do të jetojë me gruan e vet e të dy do të jenë vetëm një trup?' Kështu ata nuk janë më dy, por një trup i vetëm. Prandaj: çka Hyji bashkoi, njeriu të mos e ndajë!" Por ata vijuan: "E përse atëherë Moisiu urdhëroi: 'të jepet letërndarja e të lëshohet?'" Ai u përgjigj: "Moisiu ju lejoi t'i ndani gratë tuaja për shkak të karakterit tuaj të pagdhendur. Por në fillim nuk ka qenë ashtu. (Mateu 19, 3-8)

Dhe këtë punën e martesës natyrore e konfirmoi dhe e vulosi edhe vetë Jezu Krishti. Por tani si ka mundësi se u bë Sakrament? **Pjesa biblike më e saktë nëpërmjet të cilës kuptojmë që Martesa për të pagëzuarit (pra për ata që jetojnë jetën e re në Jezu Krishtin) është bërë Sakrament**, dmth e përsërisim, shenjë e shenjtë, efiksase, e vërtetë, e prezencës së vetë Jezu Krishtit midis nesh, midis çiftit të martuar dhe një shenjë e dashurisë që Krishti ka për secilin prej nesh. **E gjejmë në ungjillin sipas Gjonit, në dasmën e famshme të Kanës**, në të cilën Jezusi bën mrekullinë e parë (shndërron ujin në verë).

Të tretën ditë po bëhej një dasmë në Kanë të Galilesë. Aty ishte edhe nëna e Jezusit. Në dasmë ftuan edhe Jezusin e nxënësit e tij. Kur u mbaroi vera, nëna e Jezusit i tha: "Nuk kanë më verë! [E] Jezusi i tha: "Moj burrneshë, a është punë për ne? Ende nuk erdhi koha ime!" Nëna e tij u tha shërbyesve: "Bëni gjithçka t'ju thotë!" Ishin aty të vëna gjashtë enë guri që shërbenin për larje të rëndomta të judenjve. Secila zinte dy apo tri masë. Jezusi u tha shërbyesve: "Mbushni enët me ujë!" Ata i mbushën deri në grykë. "Merrini tani - u tha atëherë - e çojani kryetarit të tryezës." Ata ia çuan. Kur kryetari i tryezës e kërkoi ujin e kthyer në verë - e nuk e dinte nga vinte - shërbyesit, që e kishin mbushur ujin, e dinin - kryetari i tryezës e thirri dhëndrin dhe i tha:

“Çdo njeri më parë vë në tryezë verën e mirë e, kur t’i nxehtë pija, sjell verë më të keqe. Ti e paskë ruajtur verën e mirë deri tani!” Kjo që mrekullia e parë e Jezusit, të cilën e bëri në Kanë të Galileesë; e dëftoi lavdinë e vet dhe nxënësit e tij besuan në të. (Gjoni 2, 1-11)

Kjo është dasma e Kanës, për ata që kanë më njohuri biblike, vargje shumë të përdorura dhe shumë të komentuar. Ja vlen vetëm të përmendim dy gjëra: e para që Jezusi bën mrekullinë e tij të parë publike dhe e dëfton lavdinë e vet pikërisht gjatë një dasme, e dyta që kjo mrekulli e parë e bërë gjatë kësaj dasme është pikërisht të shndërruarit e ujit në verë! Pra, **ky është momenti kur është themeluar Sakramenti i Martesës, pra momenti në të cilës ajo që e quajtmë martesë "natyrore", mirësinë e të cilës e konfirmoi vetë Jezusi pak më sipër, u ngrit nga vetë Jezu Krishti në një sakrament, në një shenjë të shenjtë të prezencës së Jezusit midis nesh, në një "mjet hiri specifik".**

Po ashtu, që martesë tashmë për të pagëzuarit, për të krishterët, është bërë sakrament dhe si e tillë duhet të celebrihet, e konfirmon Shën Pali pak vite më vonë: tashmë Jezu Krishti kishte vdekur dhe ishte ringjallur e ngjitur në qiell, ishin krijuar komunitetet e para të krishtera (fillimet e Kishës Katolike) kështu që patjetër Sakramenti i Martesës praktikohet ndër të krishterët:

*Gratë le t’u binden burrave të vet sikurse Zotit. Sepse burri është kryet e gruas sikurse edhe Krishti është kryet e Kishës - Ai, Shëlbuesi i Trupit. Pra, sikurse Kisha i nënshtrohet Krishtit, ashtu edhe gratë le t’u binden burrave të vet në gjithçka. Ju, o burra, duajini gratë tuaja sikurse Krishti e ka dashur Kishën dhe e ka flijuar vetveten për të për ta bërë të shenjtë duke e pastruar me larje dhe me fjalë, që të bënte gati për vete një Kishë të lavdishme, të panjollë, të parrudhë, pa ndonjë gjë si këto, të jetë e shenjtë dhe e patëmetë. Në këtë mënyrë duhet që edhe burrat t’i duan gratë e veta - porsit trupin e vet. Kush e do gruan e vet, do vetveten. Sepse askurrë askush nuk e urren trupin e vet, por e ushqen dhe kujdeset për të, porsit Krishti për Kishën. Sepse jemi gjymtyrët e Trupit të tij. ‘Për këtë arsye njeriu do ta lërë babain dhe nënën e do të jetojë bashkë me gruan e vet e të dy do të jenë një trup i vetëm.’ **Ky është mister i madh: e kam fjalën në lidhjen e Krishtit me Kishën.** (Letra e Shën Palit drejtuar Efesianëve, 5, 22-32)*

Fjalët e fundit të Shën Palit: Ky është mister i madh, na bëjnë të kuptojmë që në kontekstin në të cilin po flet (që kuptohet që është ai i martesës), e ka fjalën që tashmë martesë sakramentale e bërë midis dy të krishterëve, është një mister, një shenjë e shenjtë, pra një sakrament me fjalë të tjera, që fsheh pas një realitet më të madh që dy bashkëshortët duhet të shprehin me martesën dhe jetën e tyre: dashuria që Krishti ka për Kishën, për secilin prej nesh.

3. KUSH E CELEBRON SAKRAMENTIN E MARTESËS?

Kemi thënë që përsa i përket Sakramenteve të tjera, në rastin e Pagëzimi ai që administronte këtë sakrament (pra që e jepte) ishte prifti në rastet e zakonshme, por vetëm në raste të jashtëzakonshme si psh. në rast rrezik vdekjeje, edhe laikët mund të jepnin pagëzimin; përsa i përket Krezmimit, kemi thënë që vetëm Ipeshkvi mund ta jepte këtë Sakrament; Përsa i përket Sakramentit të Meshës së Shenjtë, vetëm prifti mund të celebrtojë Meshën; përsa i përket Rrëfimit dhe Vajimit po ashtu vetëm prifti mund t'i administrojë këta Sakramente. Ato që administrojnë (japin) sakramentet i kemi quajtur me fjalë më "teknike" ministra të sakramentit. Po përsa i përket Sakramentit të Martesës? **Përsa i përket Martesës, janë nusja dhe dhëndrri ata të cilët janë ministrat e Sakramentit të Martesës! Pra, nusja dhe dhëndrri i japin njëri tjetrit sakramentin e Martesës, duke shprehur përpara Kishës konsensusin e tyre, pra pëlqimin, miratimin reciprok:** dmth që secili prej tyre dëshiron dhe ka vendosur lirisht që të martohet me tjetrin. Pra, nuk është prifti ai që i marton, dmth që ju jep sakramentin e martesës dhëndrrit e nuses, por janë ata të dy që ja japin njëri tjetrit.

Po prifti çfarë lidhjeje ka në këtë mes, nuk u dashka gjë atëhere? Jo, nuk është e vërtetë. **Prifti (më saktë akoma, famulltari) duhet të jetë i pranishëm në celebrimin e sakramentit të Martesës sepse është ai që merr pëlqimin (miratimin) reciprok të dhënë nga nusja e dhëndrri dhe u jep bekimin atyre.**

Për të treguar se si me të vërtetë dhëndrri e nusja janë ministrat e sakramentit të Martesës, ja vlen të përmendim që shumë vite më përpara Kisha deklaronte të ligjshëm (pra i lejonte) martesat klandestine, të bëra fshehurazi, pa praninë e priftit. Por duke qenë se pastaj disa tregoheshin tepër dinakë dhe pasi kishin celebruar në mënyrë klandestine sakramentin, e braktisnin bashkëshorten/in dhe shkonin e martoheshin zyrtarisht me dikë tjetër, duke bërë gjasme se ishin të lirë/të pamartuar, atëhere Kisha ndërhyri dhe vendosi që t'i urdhërojë shpalljen e martesës publikisht dhe praninë e një prifti ose të një delegati të tij si kusht themelor për vlefshmërinë e sakramentit të Martesës.

Shkurt, Sakramenti i Martesës administrohet nga vetë nusja dhe dhëndrri, por për vlefshmërinë e tij duhet të jetë se s'bën i pranishëm prifti (më saktësisht famulltari), ose në rastet kur prania e këtij të fundit është me të vërtetë e pamundur, e një të dërguari/delegati të tij.

4. KUR ËSHTË I VLEFSHËM SAKRAMENTI I MARTESËS?

Duhet të dallojmë midis dy elementeve në lidhje me Sakramentin e Martesës (kjo vlen për të gjitha Sakramentet, por në mënyrë të veçantë ky dallim na intereson për Martesën): vlefshmëria e një Sakramenti dhe ligjshmëria e një Sakramenti. Ka raste kur Sakramenti është i vlefshëm, por jo i ligjshëm. Çfarë do të thotë? Le të shohim përpara kur Sakramenti i Martesës është i vlefshëm.



Për të celebruar një sakrament martese të vlefshëm, duhet që protagonistët e këtij sakramenti të jenë:

një burrë dhe një grua (pra martesë monogamike, vetëm midis individëve të seksit mashkull dhe femër, e deri këtu besoj se nuk ka nevojë të shpjegojmë më tej sepse kemi folur mjaft në pjesën "martesa natyrore", siç ka qenë në fillimet e krijimit në planet e Zotit)

të pagëzuar (Sakramenti i Martesës mund të bëhet vetëm nëq individët janë të pagëzuar në Kishë, ose të paktën njëri prej tyre, do flasim më tej në detaj)

duhet të jenë në gjendje të lirë (pra jo të lidhur me një martesë tjetër):

dhe që shprehin lirisht konsensusin (pëlqimin/miratimin) e tyre. Ky i fundit është një element i domosdosshëm që përbën martesën. **Pra, pa konsensus, nuk ka Martesë!** Konsensusi është një akt njerëzor me anë të së cilit bashkëshortët i jepen njëri tjetrit: "Unë të marr ty për gruan time" ... "Unë të marr ty për burrin tim" ... Ky konsensus që lidh dy bashkëshortët plotësohet tërësisht në faktin që realisht ata të dy bëhen një "trup i vetëm". Konsensusi duhet të jetë një akt vullnetar i secilit nga palët, që duhet të jetë i lirë, e përsëris i lirë, nga çdo lloj dhune apo presioni (fizik, psikologjik etj) apo detyrimi të jashtëm. Asnjë lloj fuqie njerëzore nuk mund të zëvendësohet me këtë konsensus. Kjo është shumë e rëndësishme, sepse nëq ky element themelor nuk ekziston, sakramenti i Martesës nuk është i vlefshëm: kjo do të thotë që nuk është celebruar asnjë lloj martese, dy individët nuk janë të martuar dhe martesa në këtë rast është "null".

Tani, besoj se ju keni dëgjuar të flitet shumë në lidhje me "anullimin e martesave në Kishë". Unë kam njohur personalisht disa veta që u është anuluar martesa në Kishë dhe po ashtu njoh një shok, i cili punon në gjykatën eklesiastike (që është enti përkatës që merret me anulimin e martesave në Kishë) në Kroaci dhe më ka treguar për raste të ndryshme. Do të shikojmë më tej

se **Kisha nuk ka të drejtë të prekë, pra të anullojë një Sakament Martese që është i vlefshëm**, kurrë dhe në asnjë rast, (edhe sikur bashkëshorti të bëhet, larg qoftë, një kriminel i tmerrshëm apo një mafioz apo vrasës serial!), por **Kisha mund të anullojë vetëm ato Martesa që kanë qenë jo të vlefshme (pra që në fakt nuk është kryer aspak Sakramenti i Martesës). Më saktë, thuhet që Kisha në këto raste "deklaron null" këto Martesa në kishë, ose jep vendimin e nullitetit të martesave**, të cilat në fakt nuk kanë qenë kurrë të tilla, sepse kanë qenë jo të vlefshme, duke qenë se kanë munguar një ose disa nga elementet që do të përmendim më poshtë, që janë të domosdoshme për validitetin e sakramentit të martesës.

Shembull. Shembulli konkret i një gruaje që njoh, e cila ka celebruar në Kishë Sakramentin e Martesës me burrin e saj, në mënyrë të vlefshme, dhe në vitet e para të martesës shkante gjithçka mirë e ai ishte një burrë dhe një baba shumë i mirë, edhe mjaft besimtar. Papritmas, ai fillon e kalon një krizë të fortë, gjatë së cilës duket sikur "shndërrohet në një përbindësh", duke anashkaluar dhe keqtrajtuar gruan e tij, duke lënë mënjanë familjen, duke u larguar për javë e muaj të tërë edhe jashtë shtetit, duke shkuar me gra të tjera e gjëra të tilla të tmerrshme. Kjo histori është shumë e dhimbshme dhe vuajtja e kësaj gruaje duhet të respektohet e gjitha, por, edhe pse kjo grua, katolike praktikante, ka provuar dhe provon pafundësisht që të anullojë këtë martesë që për të është një dështim i vërtetë, për të qenë e lirë përfundimisht nga ky burrë dhe pse jo, për t'u rimartuar po qe puna, asnjëherë nuk ka arritur ta marrë deri tani anulimin e martesës, sepse nuk i plotëson kriteret: Sakramenti që ajo dhe burri i saj, edhe pse pastaj fatkeqësisht për të është shndërruar në një mankth, është i vlefshëm, ata të dy përpara kanë dhënë konsensusin e tyre lirisht dhe vullnetarisht e publikisht në kishë para priftit, kështu që nuk mund të anulohet.

Cilat janë arsyet për të cilat një martesë është e pavlefshme?

Folëm më sipër se kur një martesë është e vlefshme, dhe nga kjo rrjedhin arsye të tjera që do të listoj më poshtë që shkojnë kundër këtij "përkufizimi" të martesës sakramentale, për të cilat pra martesa është e pavlefshme, është "null". Por, ka edhe disa arsye të tjera, të cilat janë të përcaktuara nga vetë Kisha Katolike, më saktë gjenden të shkruara në Kodikun Kanonik të Kishës, të cilat nqs nuk respektohen, bëjnë që një sakrament martese të jetë i pavlefshëm. Le t'i shikojmë së bashku.

Tre janë arsyet kryesore për të cilat një martesë është e pavlefshme (null):

1. Për difekt në konsensus: thamë që konsensusi (pëlqimi/miratimi) që duhet të jetë i vullnetshëm, reciprok, i lirë dhe i sinqertë midis burrit e gruas është element themelor që përbën martesës: kur ky mungon, ose është me difekt në formë ose në substancë, martesa është e pavlefshme. Këto difekte mund të jenë:

injurancë mbi natyrën e martesës dhe të detyrimeve të saj: që martesa është e përhershme, midis një mashkulli dhe femre, që është e drejtuar drejt riprodhimit. Nqs një njeri nuk është i

mirëinformuar në lidhje me këto elemente ose i injoron vullnetarisht dhe martohet me këtë "injurancë", martesë nuk është e vlefshme.

gabim mbi personin ose mbi cilësitë e tij që janë themelore për konsensusin: siç mund të jenë mangësi në përdorimin e arsyes, mangësi në aftësinë e gjykimit, mangësi të natyrës psikike, kur shkëmben një person me një tjetër (rast tepër ekstrem, për të ngelë në histori, por mund të ndodhë!), gabim mbi një ose disa cilësi të personit që janë esenciale për konsensusin e palës tjetër (shembull: nqs Gjergji do të martojë Dilën dhe do absolutisht të ketë fëmijë nga kjo e fundit dhe ja ka thënë edhe haptas, dhe kjo e fundit, edhe pse duke qenë plotësisht në dijeni, i fsheh faktin që është sterile e që s'mund të ketë kurrë fëmijë, martesë e tyre është e pavlefshme sepse ka një gabim esencial në konsensusin midis tyre); po ashtu edhe nqs njëra palë i fsheh qëllimisht tjetrës fakte të rënda si psh që ka një sëmundje "ngjitëse" ose të pashërueshme, që ka një stil jetese shumë të gabuar, që ka ose ka patur probleme të rënda me drejtësinë, ose psh (diçka që mund të ndodhë më shpesh) kur gruaja e gënjen burrin me të cilin do martohet që është shtatzënë me të (gjithnjë përpara martesës flitet), por në fakt nuk është e vërtetë sepse gruaja e di se fëmija që ka në bark është i një tjetri

simulimi: kur një njeri bën gjasmë/shtiret se po martohet ose se do të martohet (psh martohet vetëm për t'i bërë qejfin të tjerëve ose burrit/gruas me të cilin martohet por në fakt s'ka aspak vullnetin e brendshëm për t'u martuar); kur njëri ose të dyja palët që martohen përjashtojnë fëmijët (pra kanë vendosur që përpara martesës që nuk duan të kenë fëmijë); kur përjashtohet pazgjdhshmëria e martesës (do të shikojmë çfarë është); kur përjashtohet besnikëria e martesës (dmth që burri/gruaja është krejtësisht i vendosur që nqs ka probleme, mund të divorcohet pa problem me gruan, ose kur burri (ose gruaja) ka një lidhje me një njeri tjetër që përpara martesës dhe ja fsheh palës tjetër, mundësisht mund ta vazhdojë këtë lidhje edhe pas martesës).

dhuna dhe frika: kur një njeriu, për arsye të ndryshme, i ushtrohet dhunë fizike/psikologjike e madhe dhe pa rrugëzgjdhje të tjera për palën e kërcënuar, për ta detyruar të martohet

Shembull. Le ta zëmë se personazhi ynë i shpikur Gjergji (single) dashurohet me Dilën, kryen marrëdhënie me të dhe Dila ngelet shtatzënë. Tani, familja e saj, që është shumë patriarkale dhe e egër në këto pika, sidomos babi dhe vëllai i saj më i madh, kur e marrin vesh, normalisht acarohen tepër shumë, shkojnë tek Gjergji dhe e kërcënojnë për vdekje që të martohet menjëherë me Dilën, pasi ai e ka "çnderuar" atë. Dhe duke qenë se familja e Dilës janë të njohur në të gjithë fshatin për gjakun e tyre tepër të nxehtë, Gjergjin e kap ankthi dhe i shtyrë nga një frikë e tmerrshme, detyrohet të pranojë se s'ka ku të fusë kokën dhe ka frikë për jetën e tij dhe për pasojat e tjera që mund të bien mbi të, por edhe mbi të afërmit e tij. Atëhere, siç e do zakoni dhe si një nuse e mirë, Dila martohet në kishë me Gjergjin (rigorozisht me fustan të bardhë!) dhe kështu ata fillojnë jetën e tyre "normale". Pas disa vitesh, Gjergji e Dila shkojnë në mërgim në Itali dhe shikojnë se nuk mund të vazhdohet më kështu sepse kanë shumë probleme të mëdha, që i tërheqin pas që nga fillimi i martesës së tyre të detyruar, dhe nuk janë aspak të dashuruar me njëri tjetrin (ose nuk kanë qenë kurrë). Atëhere, Gjergji i drejtohet "sacra rotës" në Romë,

gjykatës eklesiastike që merret me këtë punë, për anulimin e martesës së tij, që pas një procesi shumë të gjatë disa vjeçar dhe pas shumë dëshmish e faktesh të mbledhura, ajo jep vendimin e nullitetit të martesës së tyre, pra anulohet sepse në fakt nuk ka ekzistuar kurrë si e tillë, duke qenë e pavlefshme. Kjo sepse Gjergji nuk ka qenë i lirë në momentin e martesës.

2. Kur ka një pengesë vendimtare: ekzistojnë disa pengesa që e bëjnë të pavlefshme një martesë në kishë që janë:

pengesa e moshës: Burri para moshës 16 vjeçare dhe gruaja para moshës 14 vjeçare (që i kanë mbushur) nuk mund të bëjnë martesë të vlefshme

pengesa e impotencës: impotencë e përhershme dhe që përpara martesës që të bëhet akti seksual (si nga ana e burrit ashtu edhe e gruas), absolute dhe relative

pengesa e një martese tjetër: kur të paktën njëra palë është e martuar në kishë, edhe pse kjo martesë mund të mos jetë konsumuar akoma

Shembull 1. Marrim për shembull personazhin tonë të shpikur "Gjergjin" dhe le ta zëmë që ai ka qenë i martuar në kishë me gruan e tij (le ta zëmë që quhet "Rita"), por pas shumë vitesh ato e lënë njëri tjetrin dhe Gjergji njih një grua tjetër (le ta zëmë që quhet "Dila", çdo lloj riferimi ndaj personave ose emrave është krejt i rastësishëm, sikurse thonë nëpër disa filma :)). Gjergji do të martohet sërish në kishë me Dilën, por nuk mund ta bëjë, sepse, siç do të shikojmë më në detaj dhe do ta shpjegojmë pse-në, Gjergji nuk konsiderohet i lirë për Kishën Katolike, por i martuar dhe nuk mund të martohet sërish në kishë.

Shembull 2. Përkundrazi, nqs Gjergji është i martuar vetëm në gjendje civile me Ritën, dhe pas disa kohësh, për arsye që ata vetë i dinë, divorcohen, përta i përket Kishës Katolike Gjergji është i lirë, kështu që mund të martohet në kishë me Dilën.

pabarazia e kulteve fetare: martesë midis një njeriu të pagëzuar në Kishën Katolike dhe një jo të pagëzuar është e pavlefshme (por ka disa gjëra të tjera që duhet të thuhet në lidhje me këtë pikë, për të cilat do të flasim më tej)

pengesa e Urdhrit të shenjtë: kur një njeri ka marrë në mënyrë të vlefshme Sakramentin e Urdhrit të Shenjtë, nuk mund të martohet (për më tepër shiko: Sakramenti i Urdhrit të Shenjtë)

pengesa e betimit publik i përhershëm për dëlirësinë: këtu futen të gjithë ata që kanë bërë betim publik të përhershëm në një institucion fetar për dëlirësi, sikurse janë psh. fretërit e murgeshat: pra nuk mund të martohen

grabitja e gruas me qëllimin për t'u martuar me të me zor (ndoshta ky element ishte më i shpeshtë përpara)

pengesa e krimtit: kur njëra palë vret gruan e vet ose burrin e palës tjetër për t'u martuar me atë grua

pengesa e lidhjeve të gjakut: në linjën e drejtë, martesë është e pavlefshme si në pasardhësit ashtu në paraardhësit, si të ligjshëm ashtu edhe nga natyra; në linjën kolaterale, martesë është e pavlefshme deri në gradën e katërt (përfshirë kjo e fundit).

Shembull. linja e drejtë e gradës së parë: prindër e fëmijë

linja e drejtë e gradës së dytë: gjyshi e nipat

linja kolaterale e gradës së dytë: motër e vëlla

linja kolaterale e gradës së tretë: xhaxha e nip

linja kolaterale e gradës së katërt: kushërinjtë

pengesa e afërsisë: afërsia në linjën e drejtë në çdo lloj grade e bën martesën e pavlefshme

Shembull. afërsia në linjën e drejtë (grada e parë): vjehri me nusen; vjehra me dhëndrrin

Pengesa e ndershmërisë publike

Pengesa e afërsisë ligjore: nuk mund të martohen, në linjë të drejtë ose në gradën e dytë kolaterale, ata që lidhen nga farefisnia ligjore që rrjedh prej adoptimit.

3. Difekt substancial në formë:

Një nga elementet për vlefshmërinë e Sakramentit të Martesës është prania e priftit (famulltarit) ose e një delegati të tij. Nqs ky i fundit nuk është i pranishëm në momentin e celebrimit të këtij Sakramenti, Sakramenti i Martesës nuk është i vlefshëm: do të thotë që nuk është celebruar fare sakramenti i Martesës dhe që dy individët (burri e gruaja që duan të martohen) edhe nqs i kanë të vlefshme kriteret e tjera që pamë, nuk janë të martuar. Por është e vështirë që ky rast të ndodhë në ditët tona, dmth është pothuaj e pamundur që të mos jetë i pranishëm prifti ose një delegat i tij në celebrimin e martesës.

Po ashtu, për të qenë i vlefshëm Sakramenti, duhet të jenë të pranishëm përveç priftit famulltar, edhe dy dëshmitarët e martesës. Ja vlen të specifikojmë që roli i dëshmitarëve të martesës nuk është sikurse roli i nunit në Pagëzim/Krezmim, të cilët thamë kanë rolin e të shoqëruarit të të pagëzuarit/krezmuarit në rrugëtimin e fesë e për këtë arsye duhej të plotësonin disa kriteret që i kemi parë me vëmendje (shiko: Sakramenti i Pagëzimit; Sakramenti i Krezmimit). Në rastin e martesës dëshmitarët nuk kanë këtë rol, prandaj mund të zgjidhen pa ndonjë kriter të veçantë të përcaktuar nga Kisha. Roli i dëshmitarit të martesës është esencialisht vetëm një akt juridik, pra të dëshmojë nëpërmjet firmës së tij që martesë është kryer. Por, nqs duam të futemi pak më në thellësi të gjërave, prania e dëshmitarëve (si edhe e priftit) gjatë

Martesës është simbol edhe i eklesialitetit të asaj që po kremtohet: pra që sakramenti i Martesës është një realitet kishtar, për këtë arsye do të ishte mirë si për ata, si dhe sidomos për ata që martohen, që edhe dëshmitarët të rrëfihen dhe të kungohen në ditën e kryerjes së Martesës, që të shoqërojnë me lutjet e tyre, përveçse me praninë e tyre, miqtë e tyre që martohen.

5. KUR ËSHTË I LIGJSHËM SAKRAMENTI I MARTESËS?

Tani, kemi përdorur këtë fjalë "i ligjshëm" sepse është e vetmja fjalë që m'u duk më e përshtatshme në përkthimin nga italishtja të fjalës "lecito", ose nga latinishtja "ad liceitatem", por mos u ngatërroni dhe mos t'ju shkojë mendja menjëherë tek ligji dhe gjërat ligjore, rregullat sikur i mendojmë ne zakonisht. Do ta shpjegojmë menjëherë se për se bëhet fjalë. Kemi folur gjatë për elementet që prekin vlefshmërinë (në latinisht. *ad validitatem*) të Sakramentit të Martesës, pa të cilët thamë që Sakramenti ishte null, pra nuk ishte kryer fare.

Kurse përsa i përket "ligjshmërisë" (në latinisht *ad liceitatem*) së një Sakramenti do të bëjmë një fjalim të ngjashëm me atë që kemi thënë për Krezmimin. **Ne kryejmë një Sakrament Martese jo të ligjshëm, kur dy individët martohen në mënyrë të vlefshme, por në mëkat të rëndë.** Ça do të thotë kjo?

Duhet të dallojmë midis dy lloj Sakramentesh, mbi bazën e gjendjes shpirtërore në të cilën mund të merren: Sakramentet e të vdekurve (shpirtërisht) dhe Sakramentet e të gjallëve (shpirtërisht). Një njeri është i vdekur shpirtërisht, kur nuk është në hirin e Zotit, pra kur është në gjendje mëkati të rëndë. Atëhere, kuptohet dhe rrjedh si pasojë që Sakramentet e të vdekurve janë Pagëzimi dhe Rrëfimi (mbi bazën e rolit të tyre, për më tepër shiko: Sakramenti i Pagëzimit dhe Sakramenti i Rrëfimit), sepse shërbejnë pikërisht për të futur njeriun (Pagëzimi) ose për ta rikthyer (Rrëfimi) në hirin e Zotit, kurse Sakramentet e të gjallëve janë Krezmimi, Kungimi, Martesa, Urdhri i Shenjtë dhe Vajimi, pasi për rolin e tyre duhet që njeriu kur i merr të jetë në hirin e Zotit, të mos jetë në gjendje mëkati të rëndë. Dmth, **Sakramenti i Martesës duhet të merret në hir të Zotit, jo në gjendje mëkati të rëndë, dhe nqs merret në gjendje mëkati të rëndë, bëhet sakrilegj dhe për më tepër, bëhet jo i ligjshëm dhe jo i frytshëm ky Sakrament.** Kjo do të thotë, se edhe pse është i vlefshëm dhe dmth në asnjë mënyrë, kurrë, nuk mund të shpallet null, është jo i ligjshëm dhe jo i frytshëm, pra hiri i Zotit specifik (nqs e mbani mend më sipër kemi thënë që martesa sakramentale është "mjet hiri specifik") që merret nëpërmjet Sakramentit të Martesës në këtë rast nuk i jep frytet e veta, pasi gjen një pengesë të madhe që është mëkati i rëndë.

Le të bëjmë një krahasim për ta kuptuar. Është sikurse ne të kemi një shtëpi të madhe (shpirti ynë) dhe jashtë është një ditë e bukur me diell të shndritshëm e të ngrohtë (hiri i Zotit) dhe ne, në vend që të hapim perdet e dritaret që të lëmë të hyjë dielli, për të ndriçuar, ngrohur e për t'i dhënë shkëlqim e dritë e gjallëri shtëpisë sonë, i mbyllim dritaret me perde e me grila (mëkati), kështu që dielli, i cili është i gatshëm për të ndriçuar e ngrohur e dhënë gjallëri e jetë, nuk mund ta

kryejë funksionin e tij (frytet e hirit) në këtë shtëpi. Është një analogji që na ndihmon të kuptojmë se si mëkati e pengon hirin specifik të Martesës të veprojë, por normalisht është krahasim shumë i limituar sepse hiri i Zotit është një diell shumë më i madh, më i rëndësishëm dhe sidomos nuk është nga jashtë si dielli natyror, por nga brenda shpirtit të njeriut.

Po ashtu, nëq dy bashkëshortët pasi janë martuar në këtë gjendje, vazhdojnë të jetojnë në këtë gjendje shpirtërore, hiri i sakramentit të martesës së tyre nuk do të japë frytet e veta në zemrat e tyre derisa ato të jetojnë në atë gjendje mëkati. **Por, sikurse kemi thënë edhe për Krezmimin, nëq ata të dy pendohen për mëkatet e bëra, rrëfihen dhe kthehen sërish në hirin e Zotit, edhe hiri sakramental i martesës "rigjallërohet", kështu që fillon e jep frytet e veta dhe vepron në mënyrë specifike në zemrat e tyre dhe në martesën e tyre.** Është diçka e mrekullueshme, shprehi e mëshirës me të vërtetë të pafund të Hyjit!!!

Këto që po themi nuk janë teori boshe, por janë gjëra shumë të rëndësishme sepse i japin përgjigje disa pyetjeve esenciale që do të bëjmë më poshtë, dhe sepse jo rrallë ndodh që dy njerëz të martohen në gjendje mëkati të rëndë. Ndoshta as nuk e mendojnë si janë duke u martuar e tek, sepse shpeshherë kur martohen njerëzit e kanë mendjen kudo përveçse për të përgatitur shpirtin e tyre: fustani, lulet, kisha, kori, fotografi, ftesat, të ftuarit, dreka, dhuratat, muaji i mjaltit etj etj; shpesh ndodh që martohen në kishë më shumë sa për zakon, për emocion ose për t'i bërë qejfin dikujt. Ose edhe kur martohen për qejf të vet, nuk janë plotësisht të ndërgjegjshëm për madhësinë SHPIRTËRORE të këtij Sakramenti, sepse shpërqëndrohen nga shumë elemente të tjera, patjetër të mira e për të cilat duhet përkujdesje, por sigurisht krejt dytësore në krahasim me esencën që është të martuarit në hir të Zotit, dhe siç do të shikojmë edhe herë të tjera (Shiko: Urdhëresa e gjashtë) nuk është edhe aq e lehtë që të arrijmë përpara alterit në hir të Zotit.

Shembull 1. Dy të fejuar (Gjergji e Dila) të pagëzuar, të krezmuar, sapo kanë përfunduar kursin e përgatitjes paramartesore, dhe vendosin datën e martesës në kishë: martohen në një kishë të bukur në qendër të Romës, fustani i nuses shumë i bukur, edhe dhëndrri mjaft elegant, pak të ftuar por shumë të kënaqur e të emocionuar. Celebrohet sakramenti i martesës nga dy ministrat e sakramentit (pra Gjergji e Dila), marrin bekimin, dalin nga kisha, i brohorasin, i hedhin pak oriz, ndërkohë që sytë e tyre pothuaj verbërohen pak nga dielli djegës roman, pak nga flash-et e fotove që i shkrepin pa pushim, si të ishin dy VIP-a duke ecur në tapetin e kuq në festivalin e Cannes. Gjithçka e mrekullueshme, të gjithë janë aq të kënaqur dhe aq të lumtur, po të mos ishte për diçka: që ka shkuar gjithçka vaj, përveç sakramentit të tyre! Në çfarë kuptimi? Gjergji e Dila në fakt kanë bashkëjetuar deri ditën përpara se të martohen, kanë kryer marrëdhënie seksuale deri ditën përpara se të martohen, janë rrëfyer sa për të thënë ngaqë gjatë celebrimit të Meshës do të merrnin Kungimin, por pa pendim (këtë mospendim e tregon vetë mënyra e tyre e të jetuarit, që deri në momentin e fundit nuk janë përkujdesur për respektimin e Urdhëresave). Martesa e tyre është krejt e vlefshme, pra ata janë martuar me të vërtetë, por është e paligjshme, dmth hiri specifik që duhej të merrej nëpërmjet sakramentit të Martesës nuk mund të merret nga asnjëri prej tyre, sepse në momentin që ata morën sakramentin, edhe pse demok të rrëfyer e të kunguar

në sytë e të tjerëve, janë në gjendje mëkati të rëndë, të papenduar sinqerisht. Sakramenti i tyre është dhe do të jetë krejt i pafrytshëm, deri në momentin që ato të rikthehen në hir të Zotit.

Shembull 2. Ndodh që këto dy "newlyweds", "pëllumbi e pëllumbesha të sapomartuar" shkojnë në Bali (Indonezi) për pushime dhe aty papritmas (pikërisht gjatë muajit të mjaltit!) Gjergjin, që përpara rrallëherë shkonte në kishë, e kap një nostalgji e paparë për të parë Meshën, si një thirrje e jashtëzakonshme, e brendshme, e parezistueshme. Kështu që ndërkohë që gjendet në një nga ishujt e humbur të Balit, pranë Dilës që po merr pak "suntan" dhe po kënaqet nën rrezet e diellit përvëlues dhe me rërën e bardhë si bora, ai ndjen këtë dëshirë për të shkuar për të shijuar një "diell" tjetër, një diell që ngroh zemrën, të cilit ai e kupton papritmas se i kishte mbyllur dyert e shtëpisë së vet prej kohësh. E ja pra që merr taksinë, ose më mirë i thërret njërit aty në plazh që kishte një makinë dhe që improvizohet taksist, i thotë (më shumë me gjeste se me fjalë) që ta çojë tek kisha katolike më e afërt (rreth dy orë larg, më e afërta) për të parë meshën. Ishte dita e Pashkës! Arrin të bindë edhe Dilën, e cila vishet me zor, e përcëlluar siç ishte nga rrezet e flakta të diellit indonezian. Dhe kështu, mes ca drithërimave që nuk kishin përjetuar më përpara, një pjesë e të cilave vinin nga fakti që kishin ethe prej se ishin djegur nën diell, në të cilin kishin qëndruar pa asnjë lloj mbrojtjeje (të mençur eee!), ata nisen në këtë aventurë të re: nuk e kam fjalën vetëm aventurën e të gjeturit të kishës "më të afërt", të të marrurit vesh me një shofer balez që nuk flet asnjë fjalë anglisht dhe që s'ja ka idenë e kishave pasi është hinduist, të të kaluarit të pyllit tropikal ndërkohë që temperatura trupore u rritej në mënyrë eksponenciale, të të kërkuarit në këtë mes edhe të një farmacie për të blerë ndonjë krem freskues me aloe ose ndonjë paracetamol, të cilat normalisht fati do që t'i gjenin krejt boshe pasi kishin qëlluar pikërisht në ditën e festës më të madhe hinduiste, në të cilën kishin ardhur aq shumë njerëz sa i kishin mbaruar të gjitha ilaçet e farmacisë, të të humburit të kartës së kreditit dhe të të përfunduarit të gjithë parave të tyre ndërkohë që mundoheshin të telefonin ata të bankës në vendlindje për t'ju bllokuar kartën.... (e mund të vazhdoj edhe më tej por po ndalem) por e kam fjalën për aventurën e re të shpirtit të tyre: kthimin e tyre tek Zoti dhe hyrjen e tyre sërish në jetën e hirit: në atë çast ata rrëfehen (edhe pse nuk e dinë se sa shumë do t'i kuptojë prifti) dhe marrin Kungimin: u qëllon edhe një Meshë në anglisht përbiles! Sa me fat! Ja pikërisht në atë moment, rigjallërohet edhe hiri i marrë nëpërmjet Sakramentit të Martesës dhe fillon e jep frytet e para... (normalisht mund ta keni kuptuar që kjo histori, edhe pse pak e adaptuar për shembullin, ka tepër shumë detaje për të qenë e trilluar,... dhe gjejeni pak e kujt mund të jetë kjo "pothuaj" true story???)....

6. CILA JANË KARAKTERISTIKAT E SAKRAMENTIT TË MARTESËS?

a. Monogamia

Martesa e krishterë është monogamike, pra lidhja martesore midis një burri dhe një gruaje është unike dhe ekzklusive. Këtu hidhen poshtë të gjitha opinionet e kundërta, sidomos ato që mbështesin poligaminë (më e përhapur sidomos në fenë islamike) ose "forma" të tjera të

dashurisë "së lirë" (e ashtuquajtura "free love") siç mund të jenë polidashuria (si psh çiftet me mentalitet "të hapur"), polibesnikëria, martesë në grup apo gjëra të tilla. Lëvizje që me gjithë respektin, përveçse disa janë jashtë çdo llogjike njerëzore, por shkojnë krejtësisht kundër karakteristikave të martesës së krishterë, por do të shkoja më tej, kundër martesës në përgjithësi, edhe të ashtuquajturës martesë natyrore, pra siç e ka menduar Zoti për secilin prej nesh. Çdo njeri është i lirë në këtë botë të zgjohet në mëngjes e të vendosë një "formë të re" dashurie për veten e vet, si psh mund të vendosë (siç i kemi dëgjuar ca raste) të martohet me një lopë ose me një pemë, dhe askush nuk mund ta ndalojë, se pra jetojmë në një shoqëri të lirë. Por le të dijë secili prej nesh që këto forma janë krejtësisht "out", krejtësisht larg dhe kundër asaj çka ka menduar Zoti secili prej nesh dhe kështu që të mos bëjmë iluzione koti, edhe pse këto forma të lira të shprehjes së dashurisë na duken sikur na japin liri të plotë e vetëvendosje të madhe: nuk do të jemi kurrë të lumtur nqs përqafojmë ndonjërin prej këtyre formave të martesës, sepse "recetën" e lumturisë së vërtetë e ka vetëm Zoti ynë, që na ka krijuar ai vetë dhe e di vetëm Ai se çfarë është mirë për ne e çfarë jo. Këto na i konfirmon edhe një herë vetë Jezusi: "Kështu që nuk janë më dy, por një trup i vetëm" (Mateu 19, 6).

Këtu duhet të shtojmë faktin që uniteti dhe ekzkluziviteti i martesës garantohet edhe nga fakti që dinjiteti i burrit dhe i gruas për Zotin dhe për Kishën është krejt i njëjtë: pra burri e gruaja kanë dinjitet të njëjtë! Kjo është diçka shumë e bukur dhe shumë e "përparuar", nqs mendojmë se për vite, sidomos në shoqëritë patriarkale, gruaja nuk ka patur një dinjitet të njëjtë me burrin e vet, përkundrazi ka qenë pothuaj përherë e shtypur dhe e nënshtuar ndaj tekave të burrit. Kurse për Zotin kjo gjë është e papranueshme: midis dy palëve duhet të ketë respekt, dëgjim, dashuri e përkujdesje reciproke dhe asnjëra palë nuk duhet të çenojë dinjitetin njerëzor të tjetrës, e as të trajtojë palën tjetër si skllave:

Në këtë mënyrë duhet që edhe burrat t'i duan gratë e veta - pors trupin e vet. Kush e do gruan e vet, do vetveten. Sepse kurrë askush nuk e urren trupin e vet, por e ushqen dhe kujdeset për të, pors Krishti për Kishën. (Letra e Shën Palit drejtuar Efesianëve, 5, 28-29).

b. Pazgjidhshmëria

Atëherë iu paraqitën disa farisenj dhe, me qëllim që ta sprovonin, e pyetën: "A është e lejueshme ta lëshojë burri gruan për ndonjë arsye." Jezusi iu përgjigj: "A nuk keni lexuar: Krijuesi, kur i krijoi në fillim i krijoi mashkull e femër e tha: 'Për këtë arsye njeriu do ta lërë babain e nënën e vet e do të jetojë me gruan e vet e të dy do të jenë vetëm një trup?' Kështu ata nuk janë më dy, por një trup i vetëm. Prandaj: çka Hyji bashkoi, njeriu të mos e ndajë!" (Mateu 19, 3-6)

Këto janë vargjet e ungjillit sipas Mateut në të cilat flitet për pazgjidhshmërinë e sakramentit të Martesës: vetë Jezusi i thotë farisenjve, të cilët e pyesin nqs ishte i lejuar divorci apo jo (pasi Moisiu ja kishte lejuar atyre), dhe Jezusi jo vetëm që nuk është i lejuar divorci, por përbiles burri e gruaja kur martohen, janë një trup i vetëm tashmë dhe për më tepër atë çka Hyji bashkoi, njeriu të mos e ndajë (në një ungjill tjetër thuhet përbiles: njeriu të mos GUXOJË ta ndajë!) **Pikërisht**

në këto fjalë të Jezusit, që nuk lënë vend për keqkuptime, bazohet një nga karakteristikat kryesore të martesës sakramentale që është pazgjidhshmëria. Pra, në fenë tonë katolike, për të pagëzuarit në Kishën Katolike, nuk është i lejuar divorci dhe as nuk mund të flitet për divorc, nuk ekziston fare, duke qenë se martesë në kishë është e pazgjidhshme, nëq bëhet martesë në kishë (normalisht duhet të jetë e vlefshme), nuk mund të zgjidhet nga askush, sepse është Hyji që e ka themeluar dhe është Hyji që i lidh këto dy njerëz: e kemi thënë më sipër që martesë është me institucion hyjnor, jo njerëzor: as Papa, Ati i Shenjtë, nuk mundet ta zgjidhë, askush, asnjëherë.

Prandaj në kurset parapërgatitëse për martesën, ata që do të martohen përgatiten me kujdes (ose të paktën kështu duhet të jetë) nga prifti/famulltari dhe nga bashkëpunëtorët e tij, sidomos mbi këtë pikë. çdo i pagëzuar duhet ta ketë të qartë këtë pikë, pasi nuk dua ta bëj tepër të rëndë ose drastike, por ajo që u bë, u bë, nuk kthehem dot mbrapsht. Por kjo nuk duhet të na bëjë me ankth apo ta na mbushë me frikë: obobo, tani nuk kthehem dot mbrapsht, si i bëhet! Së pari, ky Sakrament është krijuar nga Zoti në këtë mënyrë për bukurinë dhe madhësinë e të qenit një trup dhe një shpirt i vetëm, i të paturit një mik/mike, i cili të shoqëron, të rri pranë dhe ndan me ty gjithë jetën e vet. Në këtë mënyrë, nëq e jetuar ashtu si do Zoti, lidhja midis dy bashkëshortëve, bëhet lidhja më intime dhe më e thellë që njeriu mund të jetojë në këtë tokë, përtej lidhjes që secila krijesë ka me Krijuesin e vet.

Dua të sjell disa fjalë të Shën Gjon Gojëartit, i cili në fjalimet e tij ishte me të vërtetë gojëartë: u sugjeronte të rinjve që përgatiste për martesë, që t'i bënin njëri tjetrit këtë fjalim, por jo thjesht si diçka mekanike, e mësuar përmëndësh, por si diçka e thellë, reale, e vërtetë, që ato realisht ndjejnë e besojnë:

"Të kam marrë në krahë, të dua, të preferoj ty para vetë jetës sime. Në fakt, ekzistenca e tanishme është si një fllad kalimtar dhe dëshira ime më e madhe është që ta kaloj me ty në mënyrë që të kem sigurinë që nuk do të jemi të ndarë në jetën e ardhshme... E vë dashurinë ndaj teje sipër gjithçkaje dhe asgjë tjetër nuk do të ishte më e dhimbshme për mua se sa të mos jem përherë në sintoni me ty".

c. Besnikëria

"Në shtëpi nxënësit e pyetën përsëri për të njëjtën gjë. Ai u tha: "Kush e lëshon gruan e vet e merr një tjetër, bën kurorëthyerje kundër së parës. Po qe se edhe gruaja e lëshon burrin e vet e martohet me një tjetër, bën kurorëthyerje." (Marku 10, 10-12)

Një karakteristikë tjetër e martesës sakramentale është besnikëria e bashkëshortëve. Pra, ashtu sikurse për monogaminë dhe pazgjidhshmërinë, dy bashkëshortët duhet të dinë se në një martesë të krishterë bashkëshortët duhet t'i qëndrojnë besnik njëri tjetrit. Kjo gjë vlen edhe për martesën natyrore, pasi sikur kemi thënë më sipër këto karakteristika janë të vetë martesës që është themeluar nga Hyji që në fillimet e Krijimit të tokës e të njeriut, por në martesën sakramentale marrin një kuptim e një rëndësi akoma edhe më të madhe. Mund të duken

fjalë boshe këto që po themi, sepse këtë punën e besnikërisë (ndoshta) arrijmë ta kuptojmë më shumë se sa atë pazgjidhshmërisë: cili bashkëshort/e në botë është i kënaqur kur zbulon se gruaja/burri e ka tradhtuar, ose nuk preket apo nuk lëndohet fare? Dhe cili grua/burrë i martuar kur shkon me një tjetër, ndjehet krejtësisht rehat, sikur të kishte bërë diçka krejt normale? Tradhtia bashkëshortore, sidomos në ditët tona, është diçka që po përhapet gjithnjë e më shumë dhe për shkak të përhapjes masive, shoqëria e sotme e "banalizon" apo e "nënvlerëson" këtë fenomen gjithnjë e më shumë, duke shkuar deri në fraza të tipit "hajt se s'ka bërë gjë të keqe, s'ka vra njeri" "në fund të fundit nuk e donin më njeri tjetrin" "e meritonte ajo, se si shtrigë ishte" "ç'të keqe ka, mjafton të mos zbulohen" "ecin përpara kështu, ajo e tradhton nga njëra anë, ai nga ana tjetrit, të paktën martesën e ruajnë sa për sy e faqe" e gjëra të tilla, mund të shtojmë pafundësisht. Sado që të kërkojmë ta nënvlerësojmë, ta banalizojmë, kurrsesi nuk do të mund të eliminojmë pasojat negative tepër të rënda që shkaktojnë në shpirtin e secilës palë (pra edhe të palës që tradhton, jo vetëm të asaj që tradhtohet) e mbi të gjitha, në shpirtin e fëmijëve të çiftit, nqs ata kanë fëmijë. Janë plagë të thella, shumë të vështira për t'u shëruar, që krijojnë probleme të pafundme dhe të paimaginueshme në ata që janë të përfshirë.

Edhe në kultura dhe në fe të ndryshme thyerja e besnikërisë martesore shikohet me një sy shumë të keq, edhe pse nganjëherë fajtorëve u viheshin dënime dhe pesha tepër të rënda, që nuk shprehin aspak faljen e mëshirën e Hyjit. Si psh në shoqërinë hebraike, ku ajo që zihej në tradhti bashkëshortore duhej të vritej me gurë; edhe sot e kësaj dite në disa shoqëri islamike të rrepta, si ajo iraniane, ekzistojnë akoma këto ligje. Kisha disa miq iranianë, që më flisnin për këto ligje dhe ky mentalitet akoma ekzistent atje. Edhe në shoqëritë më të përparuara perëndimore, si ajo italiane, ndoshta duke patur përpara një influencë më të madhe nga Kisha, tradhtia bashkëshortore dënohej me ligj, sikur të ishte një krim pra! Sot e kësaj dite nuk është më kështu, përkundrazi duket sikur tradhtia është bërë normë në shoqërinë italiane (dhe jo vetëm). Nuk dua të flas për drejtësinë apo jo të këtyre normave ligjore njerëzore, sepse njeriu bën gjithnjë gjëra imperfekte dhe qëllimet me të cilat i bën jo gjithnjë janë të mira dhe të drejta, por me këto fjali dua të tregoj se me të vërtetë, gjatë viteve e në kultura e fe të ndryshme, është parë tradhtia si një cënim i rëndë i diçkaje të shenjtë dhe tepër të rëndësishme, siç është besnikëria e bashkëshortëve.

Atëherë skribët e farisenjtë i sollën para një grua të zënë në kurorëshkelje. E vunë në mes dhe i thanë: "Mësues, kjo grua u zu ndërsa po bënte mëkatin e kurorëshkeljes. Në Ligj Moisiu na urdhëroi që të tillat të vriten me gurë. Po ti çka thua?" Folën kështu për ta vënë në provë që të kishin për çka ta padisnin. Jezusi u përkul e filloi të shkruajë me gisht në dhe. E, pasi ata vijonin ta pyesnin, ai iu drejtua e tha: "Kush është prej jush pa mëkat, le ta gjuajë i pari gurin në të!" Përsëri u përkul e vazhdoi të shkruajë me gisht në dhe. Ata, kur e dëgjuan përgjigjen, nisën një nga një të largohen duke filluar prej më të vjetërve. Jezusi mbeti vetëm - dhe gruaja që po qëndronte në këmbë në mes. Jezusi iu drejtua dhe i tha: "Grua, ku janë ata? Askush nuk të dënoi?" "Askush, Zotëri!" - iu përgjigj ajo. "As unë nuk po të dënoj - i tha Jezusi - Shko, por tani e tutje mos mëkato më!" (Gjoni 8, 3-11)

Ky është një episod i përshkruar në ungjillin sipas Gjonit, mbi një grua e cila ishte e martuar dhe ishte e zënë në kurorëshkelje, pra në tradhti bashkëshortore. Ai i përgjigjet asaj duke i thënë: "As unë nuk po të dënoj. Shko, por tani e tutje mos mëkato më!" Pra, nuk e dënon, ndryshe nga ato që thamë më sipër në lidhje me dënimet njerëzore, por gjithashtu nuk i thotë as sikur ato fjalitë që shkruam më sipër që banalizojnë e nënvlerësojnë tradhtinë, por i thotë, shko e mos mëkato më! Ky është edhe pozicioni, mënyra se si do të ishte mirë që secili prej nesh të vepronte në lidhje me ato që tradhtojnë: të mos dënojnë, të kenë mëshirë, të japin një shans të dytë, por edhe të mos thonë "hajt se s'ka bërë gjë të keqe, s'u bë nami njëherë shko i me një tjetër!". Normalisht, falja dhe mëshira rezulton shumë më e vështirë përsa i përket palës së tradhtuar në fjalë, akoma edhe më shumë kur kjo e fundit tradhtohet në mënyrë të vazhdueshme dhe pa asnjë lloj shenje pendimi.

Në këto raste, si edhe në raste të tjera të rënda si psh kur burri luan bixhoz duke shpërdoruar të gjitha paratë e familjes, kur përdor drogë/alkol/ është i dhunshëm etj atëhere Kisha LEJON që të bëhet ndarja fizike: pra dy bashkëshortët të mos bashkëjetojnë më njeri tjetrin. Kjo për të ruajtur integritetin e palës së tradhtuar ose të fëmijëve që mund të kenë, ose të gjendjes ekonomike/trashëgimisë së familjes, që përndryshe do vihej në rrezik të rëndë. Edhe pse mund të jenë të ndarë fizikisht ose për arsyet e lartpërmendura të ndarë me letra, prapëseprapë përpara Zotit ata vazhdojnë të jenë të martuar, sepse martesë në kishë kemi thënë që është e pazgjidhshme, në asnjë rast nuk mund të zgjidhet, as në rastet më ekstreme, që shkaktojnë më shumë vuajtje e që njerëzit dikush do të thoshte: hajt tani boll nuk janë të martuar më se kush e duron këtë njeri të tmerrshëm!

Duhet të kemi parasysh, sikur kemi thënë më sipër, që për Kishën Katolike, për të pagëzuarit është e vlefshme vetëm martesë në kishë. Kjo do të thotë që martesë vetëm në gjendje civile është kanonikisht null, pra është sikur të mos ishte bërë fare. Kështu që, nqs një burrë është i martuar në kishë, divorcohet civilisht me gruan e tij dhe rimartohet në gjendje civile me një tjetër, ky burrë përpara Zotit dhe Kishës vazhdon të jetë i martuar me gruan e parë dhe martesë me gruan e dytë nuk është aspak e vlefshme: për Kishën është sikur të mos ekzistonte. E para sepse vetëm martesë në kishë është e vlefshme për të pagëzuarit, e dyta sepse martesë në kishë është e pazgjidhshme dhe përgjithmonë ata të dy do të jenë të martuar para Zotit. Si rrjedhojë, një marrëdhënie me një grua tjetër (edhe pse serioze, përbilës të martuar civilisht) konsiderohet si një tradhti bashkëshortore e vazhdueshme nga ana e burrit.

7. CILAT JANË QËLLIMET E SAKRAMENTIT TË MARTESËS?

Kur flasim për qëllimet/objektivet e Sakramentit të Martesës, duhet të dallojmë midis dy lloj objektivesh: i fundit dhe i afërt. **Objektivi ose qëllimi përfundimtar dhe themelor i Sakramentit të Martesës, siç kemi thënë më sipër, është shenjtërimi i dy bashkëshortëve.** Pra, ne kemi thënë që martesë natyrore është ngritur nga vetë Jezu Krishti në dinjitetin e një Sakramenti pikërisht që nëpërmjet këtij mjet hiri specifik, dy bashkëshortët të shenjtërohen reciprokisht, gjithnjë me ndihmën e Zotit. Ky është objektivi jo vetëm final, por themelor, në kuptimin që nuk është vetëm objektivi kryesor, por edhe ai mbi të cilin duhet të bazohen të gjitha objektivet e tjera të afërta ose afatshkurta ose të vogla që bashkëshortët i përcaktojnë njëri tjetrit gjatë viteve të martesës: **shenjtërimi, pra arritja së bashku në Parajsë, tek Hyji, është pikëmbërritja e Sakramentit të Martesës.** Nqs nuk kemi këtë horizont, nqs nuk kemi këtë objektiv, dhe ky objektiv mundësisht duhet të jetë i përbashkët pra duhet ta kenë si burri si gruaja, të gjitha objektivet më të afërta, më afatshkurtra humbasin vlerën e tyre të vërtetë, sepse u reduktohet tërësisht kuptimi dhe duke humbur themelin e tyre, disa prej tyre edhe rrëzohen poshtë dhe bëhen të kota, boshe.

Duke patur parasysh këtë gjë, që duhet ta kemi në sfond vazhdimisht, ta fiksojmë mirë në tru e ta kemi si guidë të të gjitha vendimeve e qëllimeve të tjera: e keni dëgjuar ndonjëherë që ca njerëz (ndër të cilët edhe vetë) vuajnë nga tinnito, që është një sëmundje, ose më mirë një shqetësim fizik, që shpesh lind me njeriun dhe vdes me të (fatkeqësisht): ka të bëjë me të paturit në veshë vazhdimisht, pa ndërprerje, ditë e natë, një si punë zhurme, si tingull i shurdhët, me të cilën (zakonisht) njeriu mësohet që të bashkëjetojë: ai është prezent përherë, por rrallëherë i vihet veshi kësaj zhurme, vetëm kur jemi në qetësi të plotë ose e kemi mendjen për ta dëgjuar: ja edhe qëllimi i shenjtërimit reciprok të bashkëshortëve duhet të bëhet si puna e tinnitos për ne, për ata që martohen: ta kenë përherë prezent (por në këtë rast si diçka e mirë, jo e bezdisshme si kjo zhurma) edhe pse mund të mos e kujtojmë në mënyrë të hapur përditë, por të jetë aty dhe përbiles të veprohet e të bëhet gjithçka mbi bazën e këtij qëllimi. U zgjata sërish tek qëllimi i shenjtërimit sepse është me të vërtetë i rëndësishëm: ne duhet t'i kuptojmë gjërat nga rrënja për të kuptuar pastaj fenomenet e tjera që vijnë më tej ose qëllimet e tjera, përndryshe duken vetëm si ca rregulla të imponuara pa kuptim e kaq.

Qëllimi i afërt i martesës është perfeksionimi reciprok, që ka të bëjë si me anën afektive dhe njerëzore, pra që bashkëshortët ndihmojnë njëri tjetrin nga ana njerëzore, por edhe konkretisht me anën intime, atë të marrëdhënieve seksuale, të cilat duhet të jenë të hapura ndaj jetës! Pra, qëllimi i dytë i afërt i martesës është riprodhimi. **Dy, e përsërisim, janë qëllimet e afërta të martesës: perfeksionimi reciprok i bashkëshortëve dhe riprodhimi.** Ndahen kështu për arsye lehtësimi, për të kuptuar më mirë, por kuptohet që janë aq fort të ndërlydhura sa njëra pa tjetrën nuk do të kishte kuptim. Në martesë bashkëshortët duke i dhuruar njëri tjetrit dashuri, respekt, ndihmë, korrigjim, kritika konstruktive etj, e perfeksionojnë njëri tjetrin (nga ana shpirtërore dhe njerëzore), ndërkohë që i dhurohen plotësisht njëri tjetrit nëpërmjet akteve seksuale.

Aktet seksuale gjatë martesës duhet të jenë të hapura ndaj jetës. Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë, shkurtimisht, që në marrëdhëniet seksuale midis dy bashkëshortëve, përveç dashurisë reciproke (që shpresohet dhe mendohet se ekziston, pasi shpresojmë që asnjë bashkëshort të mos e detyrojë gruan), bashkëshortët nuk duhet të përdorin asnjë lloj kontracepsioni. çdo lloj metode kontraceptive (dhe kur them çdo lloj, e kam fjalën seriozisht çdo lloj) është mëkat i rëndë pasi shkon direkt kundër njërit nga qëllimeve kryesore të martesës së krishterë, që është riprodhimi. Nuk është ky momenti për të folur në veçanti për mëkatet dhe shkeljet, pasi këto mund t'i gjeni në pjesën e Dhjetë Urdhëresave: Urdhëresa e gjashtë. Gjithashtu, i hapur ndaj jetës nuk do të thotë që të kryejnë marrëdhënie vetëm gjatë periudhës fertile të femrës, që siç e dimë është vetëm një periudhë e shkurtër gjatë muajit dhe pastaj të rrinë ashtu, duar kryq mund të themi. Bashkëshortët mund të kryejnë marrëdhënie seksuale në çdo lloj periudhe, por duhet të kenë parasysh se përherë aktet e tyre duhet të jenë të hapura ndaj jetës, pra përdorur asnjë lloj mjeti kontraktiv. Për më shumë shikoni: Dhjetë Urdhëresat/Urdhëresa e gjashtë.

Një tjetër qëllim i afërt kryesor i martesës është përveçse riprodhimi, pra bërja e fëmijëve, edhe edukimi i fëmijëve. Mund të duken gjëra mjaft banale pasi janë gjëra që pak a shumë të gjithë i dimë (të paktën në teori) dhe aq më tepër që shumë të martuar mundohen t'i jetojnë, edhe pse me limitet e tyre. Gjithsesi, dua të përmend faktin që jo vetëm edukimi njerëzor, kulturor, arsimor (e cila nuk është detyrë e drejtpërdrejtë e prindërve normalisht) i fëmijëve është i rëndësishëm dhe detyrë themelore e prindërve, por në rastin e prindërve katolikë, edhe edukimi i krishterë i fëmijëve.

8. A MUND TË MARTOHEN NË KISHË DY NJERËZ ME FE TË NDRYSHME?

Duhet të dallojmë midis martesës midis një të pagëzuari katolik dhe një të pagëzuari të një feje tjetër të krishterë dhe martesës së një të pagëzuari katolik dhe një jo të pagëzuari.

A. Përsa i përket martesës midis një të pagëzuari katolik dhe një të pagëzuari të një feje tjetër të krishterë (ortodokse, protestante), që quhet martesë mikse (e përzier), martesë në Kishë mund të bëhet dhe është e vlefshme. Kemi thënë që sakramenti i Pagëzimit ishte i vlefshëm dhe i njohur si i tillë nga Kisha Katolike si për të pagëzuarit në Kishën Ortodokse, ashtu edhe në ato të pagëzuar në Kishat Protestante (për më tepër shiko: Sakramenti i Pagëzimit). Kështu që, martesë në Kishë (pra Sakramenti i Martesës) është i vlefshëm midis dy personave të tillë, por këto martesë për të qenë të ligjshme (kemi folur për ndryshimin midis vlefshmërisë dhe ligjshmërisë së martesës në Kishë) kanë nevojë për një licencë të caktuar nga autoriteti përkatës i Kishës.

B. Përsa i përket martesës në kishë midis një të pagëzuari katolik dhe një jo të pagëzuari (musliman, budist, hinduist, i pafe etj) kjo martesë quhet martesë me pabarazi kulturi dhe sipas Kodit Kanonik të Kishës, ekziston një pengesë në këtë lloj martesë, për të cilën martesë midis dy individëve të tillë është e pavlefshme. Pra, martesë midis një të pagëzuari

katolik dhe një jo të pagëzuarit është e pavlefshme në Kishë, POR, nëpërmjet një autorizimi të caktuar mund të hiqet kjo pengesë dhe e bën të vlefshëm martesën në Kishë. **Ky autorizim mund të jepet, por duhet të kemi parasysh që duhet të plotësohen këto "kritere":**

1. Pala katolike të deklarohet e gatshme që të largojë rrezikun e braktisjeje së fesë së vet dhe të premtojë sinqerisht që do të bëjë ç'është e mundur nga ana e saj, në mënyrë që të gjithë fëmijët të jenë të pagëzuar e të edukuar në Kishën Katolike
2. Pala jo e krishterë le të jetë e informuar në lidhje me këto premtime që do të bëjë pala katolike, që të jetë e ndërgjegjshme mbi premtimin dhe detyrimin e palës katolike
3. Të dyja palët duhet të dinë karakteristikat dhe qëllimet kryesore të martesës, që nuk duhet të përjashtohen nga asnjëra palë.

Konferenca Episkopale ka rolin që të përcaktojë mënyrën se si duhet të bëhen këto deklarata dhe premtime, dhe formën se si pala jo e krishterë do të informohet.

Gjithsesi, Kisha Katolike, siç bën një nënë e vërtetë me bijtë e saj, që i informon për rreziqet e zgjedhjeve që bijtë e saj (të pagëzuarit katolikë) mund të bëjnë dhe për pasojat e këtyre zgjedhjeve, duke i këshilluar me dashuri, **nuk i këshillon, edhe pse po ashtu nuk i ndalon, të pagëzuarit katolikë që të martohen me një person të një feje tjetër, qoftë ajo e krishterë jokatolike, por aq më tepër me një person të një feje jo të krishterë.** Kjo këshillë, shumë e vlefshme dhe që është mirë që të merret parasysh nqs është e mundur, nuk është sepse Kisha Katolike është e mbyllur ndaj personave të feve të tjera apo ka një paragjykim ndaj tyre, aspak! Por sepse, pikërisht për të gjitha gjërat që kemi thënë më sipër në lidhjet me karakteristikat e veçanta të martesës së krishterë (unike, midis një mashkulli e një femre, monogamia, pazgjidhshmëria, besnikëria) dhe sidomos për finalitetet specifike që kishte martesa në Kishë (shenjtërimi i bashkëshortëve, uniteti dhe perfeksionimi i tyre reciprok, hapja ndaj jetës) mund të gjenden vështirësi të mëdha në mirëkuptimin ose në pranimin e këtyre kritereve nga ana e palës së krishterë jo katolike ose aq më tepër në rastin e palës jo të pagëzuar, sepse vijnë nga një botëkuptim dhe një mentalitet tjetër, që mund të influencojë si marrëdhënien e dy bashkëshortëve, ashtu edhe rritjen e edukimit e fëmijëve, që sikurse thamë, për palën katolike është një detyrim që t'i edukojë, përse të jetë e mundur, në fenë katolike, me principet dhe moralitetin e Kishës Katolike. Dhe, për shkak të këtyre tensioneve që mund të lindin, për të cilat Kisha Katolike, duke qenë një nënë e vërtetë është në dijeni, mund të shfaqet në të dyja palët një tundim i vërtetë: ai i indiferencës fetare. Pra, që secila palë (por ne na intereson në veçanti pala katolike) për të ruajtur një "paqe" fallco në shtëpi e në familje, dalëngadalë, ndoshta edhe pa e kuptuar, kalon në një indiferencë fetare, pra që nuk i intereson më aq shumë për fenë e vet, aq më tepër nuk i intereson për praktikimin e fesë dhe për transmetimin e saj fëmijëve. Ky është një tundim ose një pasojë jo e vështirë, pasi sidomos në Shqipëri, kemi plot raste të tilla, ndoshta edhe secili nga ne njih ose gjendet në një situatë të tillë.

Siç e dimë, një nga vlerat kryesore të Shqipërisë të njohur ndër vitet, është toleranca fetare, pra se sa mirë bashkëjetojnë midis tyre njerëz të feve të ndryshme në një vend kaq të vogël. Kjo është sigurisht një vlerë që ja vlen ta përmendim dhe për t'u përgëzuar në lidhje me këtë, sepse kështu duhet të jetë, ngaqë jemi të gjithë krijesat e të njëjtit Zot e motra e vëllezër. Por, t'ju them të drejtën ky është një reflektim personal që kam bërë në këto vite, sidomos që nga momenti i kthimit tim tek Krishti kështu që kapeni "me pinca", ndoshta një nga arsytet e kësaj bashkëjetese paqësore është edhe fakti që siç e dimë "feja e shqiptarit është shqiptaria", që e parë nga njëra anë, është diçka e lezetshme, por e parë nga ana tjetër dhe këtu jemi për ta parë nga kjo anë sepse po flasim për gjërat e fesë katolike, do të thotë që në shqiptarët (në përgjithësi) nuk ekziston një identitet fetar i vërtetë: pra, një i pagëzuar katolik, edhe pse i pagëzuar, interesohet pak ose pothuaj aspak për fenë e vet, për gjërat e fesë së vet e për praktikimin e saj, pra është krejt indiferent ndaj saj pothuaj sikur të mos ishte katolik, kështu që pak i intereson nëq tjetri është katolik, apo musliman apo ortodoks, sepse për të, edhe pse e përsëris i pagëzuar katolik ndoshta që i vogël, të gjitha fetë janë njësoj. Ja fenomeni i përhapur i indiferencës fetare! E kështu, është normale që në Shqipëri shikojmë lidhje dhe martesë (sidomos civile) midis personave me përkatësi fetare të ndryshme: kështu ka funksionuar përpara dhe kështu vazhdon të funksionojë. Sigurisht vitet e komunizmit ateist "e kanë rrafshuar" edhe fenë (edhe pse nuk kanë arritur ta zhdukin tërësisht) dhe vlerat e saj dhe mendoj se është pikërisht ky regjim një arsye themelore e kësaj indiference fetare (shtu këtu edhe arsye të tjera të patriotizmit pothuaj ekstrem e gjëra të tilla). Me këtë dua të them që nëq ne, si të pagëzuar katolikë, nuk i njohim vlerat dhe të mirat e pafundme shpirtërore që na jep feja jonë, thesaret që fshihen në të, nuk kemi se si t'i japim vlerën e duhur edhe martesës me një njeri të së njëjtës fe: kjo jo sepse e gjithë bota duhet të jetë uniforme e duhet të krijojmë si punë sekti, por sepse duke qenë besimi katolik diçka tepër e rëndësishme për shpirtin e jetën tonë, nuk mund ta lëmë pas dore bashkëndarjen e tij me personin që do të ndajmë pothuaj gjithë jetën tonë, dhe aq më tepër, transmetimin e këtyre thesareve fëmijëve tanë: kush nga ne, nëq ka një thesar në shtëpi të një vlere të pafund, nuk do të mendonte menjëherë t'ja jepte fëmijëve të vet, për t'ja bërë jetën më të mirë e më harmonike???

Ja, këto janë arsytet e thella pse Kisha Katolike këshillon shumë fort që të martohemi me një njeri të fesë katolike dhe nuk këshillon që të martohemi me një njeri të fesë jo katolike. Sidoqoftë, as nuk ndalon njeri, përkundrazi duke qenë një nënë e mirë që i do të gjithë të shpëtuar, i hap dyert e martesës në kishë (edhe pse me disa kushte të domosdoshme sikurse pamë më sipër) të gjithë bijve e bijave të Hyjit.

Kështu që të gjithë ata/ato katolik/e që janë të martuar me një jokatolik (shumë i përhapur rasti i martesës katolik-musliman) nëq kanë dëshirë të rimarrin fenë e tyre në dorë e të fillojnë praktikimin e saj, të mos vënë duart në kokë në shenjë dëshpërimi, por të kenë parasysh që Kisha u jep mundësi edhe këtyre që të jetojnë jetën e tyre të krishterë, mjafton që të "rregulloni pozicionin tuaj në lidhje me Kishën" në mënyrën që e përmendëm më sipër për rastin e martesave me pabarazi kulturi.

9. A ËSHTË E VLEFSHME MARTESA CIVILE?

a. Martesa vetëm në gjendje civile midis dy të pagëzuarve nuk është e vlefshme në Kishë, pra për Kishën Katolike një martesë e tillë është KANONIKISHT null.

Ça do të thotë kjo konkretisht? Kjo do të thotë që nqs këta dy njerëz të pagëzuar nuk janë të martuar në Kishë, në sytë e Kishës dhe të Zotit është sikurse të ishin të pamartuar, "single" dhe kështu që nuk mund të frekuentojnë Sakramentet e Kishës Katolike. Pra, edhe pse të pagëzuar katolikë, nuk mund të bëjnë as Rrëfimin, as nuk mund të marrin Kungimin duke qenë se janë në një gjendje shpirtërore të vazhdueshme mëkati të rëndë, sepse marrëdhëniet seksuale që ata kryejnë, edhe pse brenda një martese civile, janë mëkat. Ne e dimë që Kisha njeh të rregullta, pra jo mëkate të rënda, vetëm marrëdhëniet seksuale të kryera brenda martesës sakramentale (shiko: Urdhëresa e gjashtë). Dikush mund të thotë: Punë e madhe! Po, pikërisht, punë e madhe thuhet kur nuk ja kemi idenë se sa e rëndësishme dhe sa e vlefshme është pjesëmarrja në Sakramentet e Kishës (sidomos në Sakramentin e mrekullueshëm të Kungimit), që na japin paqen, harmoninë, dashurinë, qetësinë, lumturinë që ne aq shumë kërkojmë e duam. Po nqs fillojmë t'ja kemi sado pak idenë e madhërisë së këtyre thesareve të çmuara, nuk e themi kaq lehtë "punë e madhe, s'ndryshon gjë", se jemi duke parë se sa e rëndësishme dhe sa e vlefshme është Martesa në Kishë, pra Sakramenti i Martesës.

b. Po nqs dy njerëz, të pagëzuar, janë të martuar vetëm në gjendje civile, por vjen një moment e vendosin të martohen në kishë, si i bëhet?

Thamë që martesa e dy të pagëzuarve vetëm në gjendje civile është KANONIKISHT null, dmth jo absolutisht null (sikurse ishte në rastin e martesave të pavlefshme) por kanonikisht null, dmth null për shkak të një çrregullsie. Ça do të thotë kjo konkretisht? Që edhe pse martesa e tyre vetëm civilisht është null, në momentin që ato e rregullojnë këtë çrregullsi, mund të martohen në kishë. Në këtë rast, për të marrë Sakramentin e Martesës, mund të bëhet ajo që e quajmë *sanatio in radice*, pra që martesa civile midis dy të pagëzuarve katolikë, për ndërhyrjen e Ipeshkvit, bëhet Sakrament i Martesës. Kjo mund të bëhet direkt, (pasi janë përgatitur mirë të dy, sikurse përgatiten të fejuarit për martesë), pra edhe pa ritualin tipik fetar në Kishë.

c. A mund të bëhet *sanatio in radice* për ata çifte që bashkëjetojnë por nuk janë të martuar në gjendje civile?

Jo. Edhe pse martesa civile midis dy të pagëzuarve është kanonikisht null, Kisha e njeh që një martesë civile nuk është njësoj si një bashkëjetesë, pasi e vlerëson faktin që të dyja palët janë angazhuar për një lidhje më serioze, që ka të bëjë me disa të drejta dhe detyra edhe përpara shoqërisë civile; për këtë arsye për martesën civile mund të bëhet e lartpërmendura "*sanatio in radice*", kurse për bashkëjetesën jo.

d. Nqs një njeri i martuar vetëm civilisht divorcohet, a mund të martohet në Kishë me një njeri tjetër?

Po. Nqs një çift të pagëzuarish që ka qenë i martuar vetëm në gjendje civile divorcohen nga njëri tjetri, ata (secili prej tyre, nqs do) mund të marrë Sakramentin e Martesës në kishë me një person tjetër. Kjo për arsyen e lartpërmendur, pra që martesë e tyre vetëm civile për Kishën ka qenë kanonikisht null, dmth nuk kanë qenë kurrë të martuar, por të lirë, "single". Atëhere, ata mund të martohen në Kishë si çdo njeri tjetër i lirë apo "single".

f. Po një njeri i martuar në gjendje civile, që kanë qenë i martuar përpara në Kishë me një tjetër, si konsiderohet për Zotin e për Kishën?

Kemi thënë që Sakramenti i Martesës është i pazgjydhshëm: nqs ai kryhet në mënyrë të vlefshme, burri e gruaja do të jenë të tillë përpara Zotit deri në momentin e vdekjes së njërit prej tyre, edhe pse ata mund të ndahen në gjendje civile o të rimartohen me një njeri tjetër në gjendje civile.

Shembull. Gjergji është divorcuar (në mënyrë civile kuptohet) nga një martesë në Kishë me Ritën: ai gjithsesi para Zotit e Kishës është i martuar me këtë grua. Kështu që martesë vetëm civile me gruan tjetër (normalisht që është Dila) përveçse kanonikisht null, është edhe një tradhti jashtëmartesore e vazhdueshme, kështu që Gjergji i shkretë në asnjë mënyrë nuk mund të marrë pjesë në Sakramentet e Kishës Katolike (Rrëfimi, Kungimi).

Kisha thotë po ashtu, që nqs këta pra Gjergji e Dila kanë fëmijë, sidomos kur janë të vegjël, për të mos e prishur më tej ekuilibrin e famijes së re të krijuar, sidomos të fëmijëve të pafajshëm që kanë nevojë për praninë e dy prindërve, mund të jetojnë së bashku dhe mund të marrin Rrëfimin e Kungimin vetëm nqs jetojnë si vëlla e motër (pra Gjergji e Dila nuk duhet të kenë marrëdhënie seksuale midis tyre) dhe nqs Sakramentet i marrin në një Kishë tjetër larg vendit ku ata jetojnë. Kjo jo për të qenë hipokrit e për të bërë gjërat klandestinisht, por për të mos krijuar skandal midis besimtarëve që mund t'i njohin mirë ata dhe situatën e tyre e me të drejtë (edhe pse dikush mund të thotë të shohin punën e tyre e mëkatet e tyre, po ne jse) mund të thonë: "Shiko, shiko, dikush qenka i nënës, dikush i njerks këtu eee, dmth Gjergjin e mbakën me hatër e mundet me marr Kungimin edhe pse bën si t'i dojë qejfi, e ne të shkretët këtu duke plas" etj etj. Pra, Kisha Katolike tregohet e kujdesshme dhe e respektueshme ndaj të gjithëve.

10. FAMILJA: KISHË SHTËPIAKE

Në Koncilin e Vatikanit II familja është quajtur, sipas një shprehjeje antike, "*Ecclesia domestica*", pra "Kishë shtëpiake". Kjo është shumë e vërtetë! Ne mund të mos na duket kështu, sidomos sepse shumë prej nesh, të dalë nga një Shqipëri afetare, pas 50 vitesh komunizmi ku ateizmi ishte i përcaktuar në Kushtetutë, ose edhe pse jo të dalë direkt, sepse të lindur pas rënies së këtij regjimi, por bij e bija të bijve të këtij regjimi, e kemi shumë të vështirë ta kuptojmë rrënjësisht kuptimin e thellë të kësaj shprehjeje, për arsyen e thjeshtë që nuk e kemi jetuar. Por, duhet të dimë që në fillimet e krishtëritit feja është përhapur pikërisht kështu: nëpër familje: psh, njëri i familjes takonte një nxënës të Jezusit ose ndonjë apostull, atëhere bëhej i krishterë, shkonte në

shtëpi plot me Shpirtin e Shenjtë dhe ktheheshin dhe besonin në Jezusin edhe familjarët e tij. Në Perandorinë Romake, në kohët kur krishtërimi sapa po përhapej dhe të krishterët persekutoheshin e vriteshin, familje të tëra të krishtera martirizoheshin, sepse as nëna, as babai, as fëmijët nuk donin ta mohonin fenë e krishterë. E kështu i vritnin të gjithë së bashku. Le të lexojmë një episod shumë të bukur biblik që na përngjan me fenomene të tilla:

"Në Cezare ishte një njeri me emër Kornel, kapiten i togës së quajtur "Italike", njeri i përshpirtshëm dhe që besonte në Hyjin, si ai ashtu edhe familja e tij. I ndante popullit shumë lëmoshë dhe vazhdimisht i lutej Hyjit. Ai pa qartë në një vegim diku rreth orës nëntë të ditës se si engjëlli i Hyjit hyri tek ai dhe i tha. "Kornel!" "Urdhëro, Zotëri!" - ia ktheu Korneli duke ia ngulur sytë i frikësuar. "Lutjet e tua dhe lëmoshët kanë arritur para Hyjit - iu përgjigj engjëlli - dhe ai të ka kujtuar. Ti tani dërgoju disa njerëz në Jopë dhe grishe Simonin që quhet Pjetër. Ai gjendet te një farë Simoni, lëkurëtar, që e ka shtëpinë afër detit." Posa shkoi engjëlli që foli me të, kapiteni i grishi dy shërbëtorë dhe një ushtarë të përshpirtshëm, prej atyre që i ishin dhënë për shërbim, u tregoi gjithçka dhe i nisi për në Jopë...

... "Para katër ditësh - iu përgjigj Korneli - pikërisht në këtë kohë, thosha në shtëpinë time lutjet e orës nëntë, kur ia behu një njeri në petka të shkëlqyeshme, zuri vend para meje dhe tha: 'Kornel, u vështrua lutja jote dhe u kujtuan lëmoshët e tua para Hyjit. Dërgo, pra ndokënd në Jopë dhe grishe Simonin e quajtur Pjetër. Ai është mik në shtëpinë e Simonit lëkurëtar, afër detit.' Menjëherë dërgova njerëzit për ty dhe ti bëre mirë që erdhe. Ja, pra, të gjithë jemi bashkuar para Hyjit për të dëgjuar gjithçka Zoti të ka urdhëruar."...

...Ndërsa Pjetri ende po i thoshte këto fjalë, Shpirti Shenjt zbriti mbi të gjithë ata që po dëgjonin predikimin. Besimtarët e rrethprerë që kishin ardhur me Pjetrin, u çuditën kur panë se edhe në paganë u ndikua dhurata - Shpirti Shenjt. (Veprat e Apostujve, 10, 1-8; 30-33; 44-45)

Pra, ky njeri pagan, jo hebre, Korneli, ishte njeri i drejtë dhe i mirë dhe besonte në Zotin, por nuk e njihnte atë, nuk e njihnte Jezusin. E si mund ta njihje, nqs askush nuk i kishte folur për të? E mrekullueshme dhe mallëngjyese mënyra se si vetë Hyji ndërhyr në jetën e këtij pagani, duke i dërguar Simon Pjetrin, pra Shën Pjetrin, apostullin e Jezusit dhe Papën e parë të Kishës Katolike, për t'i folur për Jezu Krishtin. Shën Pjetri, i udhëhequr nga Shpirti Shenjtë, nuk vonon që të shkojë tek Korneli e t'i tregojë gjithçka në lidhje me Jezusin. Por ka një detaj: kur Pjetri vjen për t'i shpallur Krishtin dhe pastaj për t'i pagëzuar e për t'ju dhënë Shpirtin e Shenjtë, Korneli nuk gjendet vetëm: janë ai dhe e gjithë familja e tij, që e presin së bashku, me respekt dhe me lutje Pjetrin dhe pra Shpirtin e Shenjtë që ai ju jep. Është një përfytyrim shumë i bukur dhe një shembull për ne: ne nuk marrim Shpirtin e Shenjtë, pra nuk besojmë në Jezusin se jemi më të mirë ose ato më fat ose ato që na ka ra "telebingoja" për të besuar tek Jezusi dhe të tjerët e familjes "jo, s'duan ato, s'është se besojnë fort, secili ka mendimin e vet, beson në mënyrë e vet". Ej, nuk na është dhënë dhurata e fesë për ta mbajtur për vete, na është dhënë që këtë shpëtim që Jezusi na jep neve, ne të bëhemi instrument edhe për të tjerët e familjes. Po, po, ne, unë, ti. E

mos ta kthejmë kokën mbrapsht, të tipit "kush, ti? Se unë jo, s'ka mundësi", si ata që kur nuk duan të marrin një farë përgjegjesie, kthehen mbrapsht, anash e përpara e mbrapa për të gjetur ndonjërin për t'ja lënë në dorë dikujt tjetër "pataten e nxehtë". Zoti na thërret, ne, secilit prej nesh, që ta ndihmojmë për të kthyer familjarët tanë, së pari.

Dhe mbi të gjitha, thërret prindërit dhe u jep detyrën që të edukojnë fëmijët e tyre në fenë e krishterë, jo vetëm duke i çuar në Katekizëm e pastaj hajt se boll kanë se pastaj thellohen tepër shumë në fe, por duke u bërë vetë ata mësuesit e parë të fesë të fëmijëve të tyre, më shumë se me fjalë, me vepra, me shembullin dhe sidomos me lutjet e tyre, që është tepër e këshillueshme që të bëhen së bashku, në vatrën familjare. Është shumë themelore kjo pjesë, është kjo baza për të patur një familje të mirë, për të patur fëmijë të mirë, për të patur një shoqëri të mirë. Ja vlen të ndalemi vetëm pak tek fakti që nga një familje e mirë dhe fetare, dalin edhe thirrjet për meshtari ose për murgeshë. Mund të duken si specie në zhdukje këta të fundit, por siç do ta shikojmë në Sakramentin që vijon (Sakramenti i Urdhrit), një familje me rrënjë të krishtera dhe që i transmeton dashurinë për Krishtin fëmijëve të vet, është baza për thirrjet e ndryshme brenda Kishës, është pra baza për vetë Kishën, sepse familjet e krishtera siç e pamë më sipër, janë fillimi i Kishës Katolike, por edhe vazhdimi i saj, sepse ministrat e Kishës Katolike janë bij dhe bija të disa prindërve, të disa familjeve, në të cilat janë rritur dhe edukuar në fe.

11. A FUNKSIONON ME TË VËRTETË KY SAKRAMENT, DUKE PARË SHKATËRRIMET E MARTESAVE E TË FAMILJEVE, APO JO?

Përgjigja është: po, por varet. Me të vërtetë shikojmë, sidomos në kohët e fundit, shkatërrimin e martesave të ndryshme (si ato në Kishë, si ato jo sakramentale), që mbartin në vetvete shumë probleme, plagë, shkatërrime njerëzore dhe shpirtërore, depresion, zili, urrejtje, mëri, zënka, grindje, probleme familjare duke shkuar deri në gjykata e për të mos përmendur pasojat më drastike të vetëvrasjes apo të vrasjes. Por edhe nqs nuk shkojnë deri në këto pika si divorci dhe shkatërrimet personale e familjare që ai sjell pas, mund të vazhdojnë të martuar me njëri tjetrin, edhe vite të tëra, por duket sikur nuk janë të martuar, sikur nuk kanë një njeri pranë që i do dhe i mbështet, me të cilin të ndajnë jetën, problemet, shqetësimet, fitoret dhe rëniet e jetës. Duket sikur jetojnë në një shtëpi, por ndihen vetëm, ndihen sikur tjetri është prezent vetëm fizikisht dhe jo edhe shpirtërisht. Ka moskuptime, keqkuptime, mosmarrëveshje, tension, zënka, ulëritje, bërtitje, akuza, ndjenja faji dhe gjëra të tilla që mund të bëhen edhe të përditshme, dhe pikë pas pike, bëjnë të mbushet kupa. Vijnë atëhere lëniet mbas dore, harresat, moskokëçarjet deri në tradhti dhe në ndarje e divorc. Si ka mundësi, a thamë që Jezu Krishti e ka krijuar martesën për shenjtërimin e dy bashkëshortëve, si ka mundësi që kemi kaq pak bashkëshortë/e të shenjtë në këtë botë? Unë lëviz kokën rreth e rrotull dhe s'mundem as t'i numëroj në gishtat e dorës ata

bashkëshortë jo të shenjtë, por që i afrohen sadopak, nga larg fare, shenjtërisë! Si ka mundësi, a funksionon ky Sakrament?

Po. Të mos ja lëmë fajin Sakramentit, se nuk ka asnjë faj i shkreti! Sakramenti i Martesës e ka fuqinë e vet dhe asnjë nuk ja lëviz dot, sepse është një mjet hiri specifik, sikurse kemi thënë. Pra, hiri që ne marrim nëpërmjet këtij Sakramenti shërben pikërisht për të na dhënë një ndihmë "extra" kur na dalin përballë probleme, situata dhe tundime si ato të lartpërmendurat, por edhe shumë të tjera të ndryshme. Na jep forcë, kurajo e durim në tundimet e vështirësitë e jetës, për të përballuar jetën bashkëshortore dhe familjare në mënyrën më të mirë, më të shenjtë të mundshme, ashtu siç do Zoti për ne. Por, hiri na ndihmon dhe është e pamundur që të mos na ndihmojë, se për këtë punë është, puna është a e kemi marrë këtë hir apo jo? Po si nuk e kemi marrë tani, a thamë se janë të martuar në kishë? Një gjë është të jenë martuar në Kishë në mënyrë të vlefshme, një gjë është të kenë marrë hirin e martesës, këtë **mjet hiri specifik**. Kemi folur gjatë për ndryshimin midis martesave të vlefshme dhe atyre të ligjshme, dhe kemi thënë që një martesë është jo e ligjshme kur bëhet në mënyrë të vlefshme, por në gjendje mëkati të rëndë, kështu që hiri i Sakramentit të Martesës gjen një pengesë të madhe (mëkati i rëndë) dhe nuk mund të japë frytet e tij dhe nuk i jep, derisa të kthehen bashkëshortët në hir të Zotit, duke larguar mëkatin e rëndë nga jeta e tyre. Është themelore kjo gjë! Ta fiksojmë mirë se problemet tona në familje e me burrin e gruan (se gjithë bota për këto probleme ankohet më shumë) nuk vijnë nga kushtet e jashtme apo nga karakteri e sjellja e keqe e burrit/fëmijës/gruas etj por vijnë, dmth e kanë rrënjën e tyre shumë më thellë: këto gjëra që ne shikojmë nga jashtë nuk janë thelbi i problemit, thelbi i problemit është se nuk jetojmë në hir të Zotit, se nuk kemi hequr mëkatin e rëndë nga jeta jonë dhe nga martesja jonë dhe nuk ja kemi hapur rrugën hirit të Sakramentit të Martesës që mund të kemi marrë para një muaji, para një viti ose para 30 vitesh: nuk ka rëndësi, nuk është kurrë vonë për Zotin!

Është diçka e rëndë që të mos i japim rëndësinë e duhur hirit të Sakramentit të Martesës: është sikurse të jemi të ftuar për darkë nga një njeri që na do shumë, që na ka përzemër, na ka përgatitur pjata të mrekullueshme dhe të shijshme nga më të ndryshmet për ne, dhe ne ç'a bëjmë? Në vend që ta falenderojmë dhe t'i hamë, përbiles t'i shijojmë më së miri këto ushqime, ç'a bëjmë? I pështyjmë brenda! I afrohem secilës pjatë dhe Ptuf! Pështyjmë! Duket diçka e shpifur kjo që po them, na e shpifi (shpresoj që dikush nga ju të mos jetë duke ngrënë në këto momente) por është edhe më e shpifur ajo që bëjmë ne duke i mbyllur dyert e zemrës sonë hirit të Jezu Krishtit nëpërmjet martesës!

Po ashtu, që hiri i vërtetë i këtij Sakramenti, që siç po e shikojmë është ai që bën "ndryshimin e vërtetë" midis një martesë sakramentale dhe një lidhjeje të një lloji tjetër, të funksionojë, të japë frytet e veta me bollëk, duhet që ata që janë të thirrur nga Zoti për t'u martuar, të përgatiten mirë përpara martesës, dhe mundësisht edhe pse shumë më e lehtë për t'u thënë se sa për t'u bërë, të dy së bashku, burrë e grua. Nuk improvizohet Sakramenti i Martesës, por është kurorëzimi i një rrugëtimi të dyfishtë të bërë nga dy individët në komunitetin lokal (famullitë ose komunitete të

tjera) me ndihmën e Zotit dhe të atit shpirtëror që i ndjek. Pra, siç e shikojmë, rrënjët e problemeve që nxjerrin "kokën" e tyre më vonë, janë më të thella. Atëhere dy janë "zgjidhjet":

1. Për ata që tashmë janë të martuar në kishë ose bashkëjetojnë ose janë martuar në gjendje civile (janë martuar ashtu "siç kanë ditur" le të themi) dhe e shikojnë se ka diçka që nuk shkon në martesën e tyre, që duan të kapin këto raste që Krishti ju ofron, së pari le të pendohen për mëkatet e tyre, edhe ato të bëra më përpara martesës së tyre dhe le të rregullojnë, nqs është nevoja, pozitën e tyre në lidhje me Kishën: pra le të martohen në kishë (me mundësitë përkatëse për të cilat kemi folur më sipër). Le të rikthehen kështu në hir të Zotit, në miqësi të thellë me Krishtin dhe t'ja lënë në dorë martesën e tyre Krishtit, ai do ta udhëheqë atë sikurse një pilot i mirë e çon avionin në pikëmbërritjen e duhur.

2. Për ata që janë akoma të fejuar ose edhe single dhe mendojnë të martohen një ditë, të kenë parasysh që të "rregullojnë" situatën e gjendjes së shpirtit të tyre përpara Zotit dhe Kishës, duke u rikthyer në miqësi me Zotin (pra, në hirin e tij), duke larguar nga jeta e tyre mëkatet e rëndë dhe duke jetuar në mënyrë të tillë që të arrijnë para alterit në mënyrë të denjë (të paktën për aq sa është e mundur për një krijesë). Të jemi të sigurtë që Zoti do e bekojë një martesë të tillë me fryte e të mira të përkohshme e të përhershme. Këtë e ka garantuar vetë Jezu Krishti.

Kur? Kur ka thënë që Ai që e ndërton shtëpinë e tij (pra, vlen edhe për martesën) mbi shkëmb (ky shkëmb është vetë Jezu Krishti, miqësia me të) e ka të garantuar 100% nga Krishti që pavarësisht nga çdo lloj vështirësie (të përfaqësuar nga erërat, shiu, përrenjtë) kurrësi kjo ndërtesë (martesa) nuk do të rrëzohet. Përkundrazi, ai që e ndërton shtëpinë (martesën) e vet mbi rërë (pra mbi diçka jo të qëndrueshme dhe e vetmja gjë e qëndrueshme në këtë jetë është dashuria e Jezu Krishtit) ndërtesa do të bjerë për shkak të provave të shumta që do të pësojë. Dhe ja, porsì kjo qytezë antike në Viterbo të Italisë, Kalkata, rreth 40 km larg Romës, e cila është e ndërtuar mbi një shkëmb të madh dhe që edhe pas shumë vitesh, është shumë i fortë dhe i sigurtë, aq sa tashmë është një qytezë piktoreske e populluar nga njerëz të ndryshëm, sidomos artistë që vijnë të marrin frymëzimim e tyre nga pamja magjepsëse që e karakterizon, edhe ne jemi të thirrur të ndërtojmë martesën tonë, të ardhmen tonë mbi shkëmbin e palëkundur të dashurisë së Hyjit:



"Kështu, kushdo i dëgjon këto fjalë të mia dhe i vë në veprim, mund të krahasohet me njeriun e urtë, i cili e ndërtoi shtëpinë e vet mbi shkëmb. Ra shiu, u çuan përrenjtë, frynë erërat e u përplasën për atë shtëpi, por ajo nuk u rrëzua, sepse i kishte themelet në shkëmb. Kurse, ai që i dëgjon të gjitha këto fjalë të mia e nuk i vë në veprim, mund të krahasohet me njeriun e marrë, i cili e ndërtoi shtëpinë e vet mbi rërë. Ra shiu, u çuan përrenjtë, frynë erërat dhe u përplasën për atë shtëpi e ajo u rrëzua: rrënimi i saj qe i madh!" (Mateu 7, 24-27)

